



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 53/2019 regjistër (JR)  
Datë 25.10.2019

Nr. 27 i vendimit  
Datë 21.09.2021

**VENDIM  
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Relatore</b>
<b>Albana Shtylla</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Ardian Hajdari</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Anëtar</b>

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 21.09.2021, ditën e martë, në orën 15:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Steven Kessler, me sekretare gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

**ANKUES:** Komisioneri Publik Florian Ballhysa.

**OBJEKTII I ANKIMIT:** Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 183, datë 19.07.2019, që i përket subjektit të rivlerësimit Petrit Çano, me funksionin prokuror/drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenet C, pika 2, neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e kërkimet e Komisionerit Publik Florian Ballhysa, të paraqitura në ankim dhe të konfirmuara në konkluzionet përfundimtare, i cili kërkoi përfundimisht ndryshimin e vendimit nr. 183, datë 19.07.2019, të Komisionit të Pavarur të

Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Petrit Çano; qëndrimin e subjektit të rivlerësimit, i cili kërkoi përfundimisht lënien në fuqi të vendimit; dëgjoi gjyqtaren relatores Ina Rama, si dhe pasi e bisedoi atë,

## VËREN:

### I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Petrit Çano, në momentin e fillimit të procesit të rivlerësimit kalimtar, ushtronte detyrën e prokurorit, në funksionin si drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë. Për shkak të parashikimeve të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex-officio*.
2. Në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim "Komisioni"), për subjektin e rivlerësimit, në zbatim të neneve 33, 34 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim "ILDKPKI"); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim "DSIK") dhe Prokuroria e Përgjithshme.

2.1 ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, i dërgoi Komisionit raportin përfundimtar<sup>1</sup>, duke konstatuar se: i) deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin; ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2 DSIK-ja i ka përcjellë Komisionit raportin e kontrollit të figurës<sup>2</sup>, duke konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

2.3 Prokuroria e Përgjithshme, për subjektin e rivlerësimit Petrit Çano, i ka përcjellë Komisionit një raport<sup>3</sup> të hollësishëm dhe të arsyetuar për aftësitë profesionale.

### II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim "Komisioni"), me vendimin nr. 183, datë 19.07.2019, në bazë të germës "a" të pikës 1 të nenit 58, si dhe të pikave 1 dhe 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Petrit Çano, me funksion prokuror/drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë. Këtë vendim, Komisioni e ka mbështetur mbi konkluzionet e arritura lidhur me vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, për të cilat ka konkluduar se:

3.1 **Për kriterin e vlerësimit të pasurisë:** [...] *Nga vlerësimi në tërësi i pasurisë së subjektit të rivlerësimit, vërehet se nuk janë konstatuar elemente të cilat mund të ngrenë dyshime për fshehje apo deklarim të rremë nga subjekti i rivlerësimit. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit janë të mjaftueshme. Pas verifikimit, deklarimet e subjektit rezultojnë të sakta dhe në përputhje me ligjin. Subjekti ka burime të ligjshme për krijimin e tyre.*

<sup>1</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 22.01.2018.

<sup>2</sup> Me raportin nr. {\*\*\*} prot., datë 02.11.2017, për kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, të deklasifikuar me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 27.09.2018, të KDZH-së.

<sup>3</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*}, datë 18.12.2018, dërgohet raporti i Grupit të Punës në Prokurorinë e Përgjithshme.

**3.2 Për kriterin e kontrollit të figurës:** [...] Nga hetimi administrativ, nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës. Trupi gjykues ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit, z. Petrit Çano, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

**3.3 Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale:** [...] subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme. Nuk u provua asnjë indice apo element që cenon figurën e prokurorit Petrit Çano, sipas parashikimeve në nenin 44/a të ligjit nr. 84/2016.

**3.4 Për këto arsye, Komisioni, lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, e ka klasifikuar subjektin e rivlerësimit si “të aftë”.**

**3.5 Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, si dhe pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore publike, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Petrit Çano, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:**

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

### **III. Shkaqet e ankimit**

4. Komisioneri Publik Florian Ballhysa ka paraqitur ankim kundër vendimit nr. 183, datë 19.07.2019, të Komisionit i cili ka konfirmoi në detyrë subjektin e rivlerësimit Petrit Çano.
5. Komisioneri Publik në ankim ka parashtruar se, nëpërmjet këtij mjeti procedural, në respektim të kërkesave kushtetuese e ligjore për rivlerësimin kalimtar të subjekteve dhe në mbrojtje të interesit publik, synon kontrollin e vendimit nr. 183/2019 të Komisionit nga ana e Kolegjit, lidhur me nevojën e hetimit të mëtejshëm të kriterit të pasurisë për sa i përket mjaftueshmërisë së deklarimit dhe shpjegimit bindshëm të burimit të ligjshëm të pasurisë dhe të të ardhurave për subjektin e rivlerësimit dhe të personave të lidhur me të, referuar përcaktimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.  
Gjithashtu Komisioneri Publik, në ankim, ka parashtruar se, për shkak të faktit se raporti i DSIK-së për subjektin është hartuar pa u administruar informacioni i Shërbimit Informativ Shtetëror, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenet 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, ankimi i tij ndaj vendimit nr. 183, datë 19.7.2019, të Komisionit ushtrohet për të tria kriteret e rivlerësimit.
6. Përgjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”), Komisioneri Publik, nën dritën e një sate të re të ndodhur/zhvilluar në prokurorinë pranë së cilës ushtron funksionin subjekti i rivlerësimit, të ndryshme nga situata faktike në momentin e paraqitjes prej tij të ankimit, paraqiti edhe pretendime në drejtim të vlerësimit të kryer nga Komisioni për kriterin e aftësive profesionale, në përputhje me rolin e tij si mbrojtës i interesit publik.
7. Shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik për të tria kriteret e vlerësimit paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

## A. Lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë

7.1 Komisioneri Publik ka pretenduar se procesi i hetimit i kryer nga Komisioni për kriterin e vlerësimit të pasurisë, nuk ka qenë i plotë e, për rrjedhojë, përfundimet e arritura nuk janë të pajtueshme me provat e administruara, duke pretenduar se Komisioni për pasurinë apartament me nr. pasurie {\*\*\*}, volumi {\*\*\*}, faqe {\*\*\*}, Zona Kadastrale {\*\*\*}, sip. 102,6 m<sup>2</sup>, të ndodhur në rrugën “{\*\*\*}” (ndryshuar në rr. “{\*\*\*}”), shk. {\*\*\*}, ap. {\*\*\*}, Tiranë, nuk ka kryer një hetim administrativ shterues në 3 drejtime kryesore, që kanë të bëjnë me: **(i)** konfliktin e interesit; **(ii)** veprimeve në dukje fiktive; **(iii)** burimin e ligjshëm të të ardhurave të deklaruara se kanë shërbyer për blerjen e saj.

7.2 Për pasurinë apartament, nr. pasurie {\*\*\*}, volumi {\*\*\*}, faqe {\*\*\*}, Zona Kadastrale {\*\*\*}, me sip. 63 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, godina {\*\*\*}, hyrja {\*\*\*}, apartamenti {\*\*\*}<sup>2</sup>, Tiranë, në pronësi të personit të lidhur, vajzës së subjektit të rivlerësimit, Komisioneri Publik pretendon se Komisioni nuk ka kryer hetim shterues në drejtim të: **(i)** konfliktit të interesit; **(ii)** pagesës në vlerën 1.023.335 lekë në aplikimin pranë ZVRPP Tiranë; **(iii)** veprimeve në dukje fiktive; **(iv)** burimit të ligjshëm të të ardhurave të deklaruara nga kontrata e shitjes, në shumën 1.400.000 lekë.

7.3 Komisioneri Publik pretendon se, përveç sa më lart, përgjatë analizës ekonomike të kryer për periudhën 2003-2016, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e pamjaftueshmërisë financiare për të mbuluar me burime të ligjshme shpenzimet dhe kursimet e deklaruara në vitet 2005 dhe 2011.

## B. Lidhur me kriterin e kontrollit të figurës

7.4 Komisioneri Publik në ankim, por duke e potencuar edhe në seancën gjyqësore, ka konstatuar se, në kushtet kur nga aktet në dosje ka rezultuar se Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka dërguar raportin<sup>4</sup> mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Petrit Çano, me anë të të cilit konstatohet përshtatshmëria për vazhdimin e detyrës, pa përgjigjen e një prej tri institucioneve verifikuese, nevojitet, në respektim të parashikimeve ligjore të ligjit nr. 84/2016: *Përditësimi i raportit të Grupit të Punës në DSIK, i datës 02.11.2017, pas administrimit të informacionit përkatës nga institucioni verifikues, të dhënat e të cilit nuk janë marrë në shqyrtim gjatë hartimit të raportit të parë.*

## C. Lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

7.5 Përgjatë gjykimit në Kolegj<sup>5</sup>, Komisioneri Publik, në parashtrimet e tij, solli në vëmendje se ankimi kundër vendimit nr. 183/2019 të Komisionit, është ushtruar për të tria kriteret e rivlerësimit. Nisur nga kjo premisë, Komisioneri Publik ka kërkuar nga Kolegji vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, duke konsideruar për këtë qëllim ngjarje të ndodhura pas paraqitjes së ankimit të tij kundër vendimit objekt shqyrtimi. Këto ngjarje i referohen faktit se në muajin janar të vitit 2021, është iniciuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë procedimi disiplinor, për një nga magjistratët/prokurorët e zyrës së prokurorisë<sup>6</sup> që drejtohet nga ana e subjektit të rivlerësimit, për të cilin, në përfundim të procedurës përkatëse disiplinore, është vendosur

---

<sup>4</sup> Të deklasifikuar me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 27.09.2018, të KDZH-së.

<sup>5</sup> Në parashtrimet e seancës gjyqësore të datës 27.04.2021, të publikuara në faqen zyrtare në internet të Komisionerit Publik:

<http://ikp.al/wp-content/uploads/2019/10/Parashtrimet-e-%C3%A7%C3%ABshtjes-dat%C3%AB-27.4.2021.pdf>

<sup>6</sup> Për prokurorin B. M..

shkarkimi nga detyra lidhur me kryerjen e shkeljeve disiplinore në të paktën katër gjykime të kërkesave të paraqitura nga të dënuarit gjatë fazës së ekzekutimit të vendimeve penale. Në konsideratë të kësaj situate faktike, Komisioneri Publik ka parashtruar në seancë gjyqësore kërkesën për hetime të mëtejshme në drejtim të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, të detajuara e shtjelluara në vijim të këtij vendimi.

#### IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

##### A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

##### a) Juridiksioni i Kolegjit

8. Në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji i Posaçëm i Apelimit (në vijim “Kolegji”) ka juridiksion (*ratione materiae*) të shqyrtojë ankimet kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, i parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, duke pasur për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit mbi bazën e ankimit të Komisionerit Publik dhe duke mos qenë në kushtet e parashikuara nga neni E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit.

##### b) Legjitimimi i ankuesit

9. Komisioneri Publik legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës.

9.1 Kolegji, në kuptim të *ratione temporis*, mori në shqyrtim pretendimin e subjektit të rivlerësimit se ankimi i Komisionerit Publik, i cili është protokolluar në datën 03.10.2019, ishte paraqitur jashtë afatit 15-ditor, të parashikuar nga neni 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

9.2 Kolegji, referuar akteve të administruara në fashikullin e krijuar nga Komisioni, konstatoi se vendimi objekt shqyrtimi nr. 183, datë 19.07.2019, rezultonte të ishte depozituar pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë më datë 18.09.2019 dhe jo në datë 17.09.2019, siç pretendonte subjekti i rivlerësimit. Ky fakt rezultoi i provuar nga dokumenti ligjor i titulluar “Marrje njoftimi”, i nënshkruar nga punonjësi përgjegjës i administratës së institucionit<sup>7</sup>.

9.3 Nisur nga fakti i provuar si më lart, llogaritja e afatit të paraqitjes së ankimit të Komisionerit Publik objekt i këtij gjykimi, do të kryhet në raport me datën 19.09.2019. Referuar parashikimit të nenit 3, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit: “Ditë” nënkupton ditë kalendarike që llogariten sipas rregullave të përcaktuara në nenin 56 të Kodit të Procedurave Administrative, Kolegji analizoi pretendimin e subjektit sipas normës referuese përkatëse, e cila parashikon se: *kur afati caktohet në ditë, në llogaritjen e tij përjashtohet dita kur ka ndodhur ngjarja, nga e cila fillon të ecë afati*. Në zbatim të këtyre dispozitave dhe në analizë të rrethanave të faktit të përshkruara më lart, Kolegji llogariti afatin prej 15 ditësh, të parashikuar nga neni 63 i ligjit nr. 84/2016, brenda të cilit mund të paraqitet ankimi ndaj një vendimi të Komisionit, duke e filluar numërimin e ditëve nga data 19.09.2019, që i takon së nesërme të datës 18.09.2019, ditë në të cilën vendimi i Komisionit i është komunikuar zyrtarisht Institucionit të Komisionerëve Publikë. Në konkluzion

---

<sup>7</sup> Vendimi i arsyetuar nr. 183, datë 19.07.2019, i është njoftuar Komisionerit Publik me shkresën nr. {\*\*\*}, datë 17.09.2019, për të cilën Komisioneri Publik ka nënshkruar shkresën “Lajmërim marrje” për administrimin e këtij vendimi më datë 18.09.2019.

të kësaj analize, rezultoi se ankimi i Komisionerit Publik, i paraqitur në datën 03.10.2019, është brenda këtij afati dhe Komisioneri do të konsiderohet se plotëson kushtin *ratione temporis* në verifikim të këtij elementi të legjitimitetit formal të tij.

*c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

10. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit ndaj vendimit nr. 183, datë 19.07.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke qenë se është ushtruar nga Komisioneri Publik, u zhvillua në seancë gjyqësore publike.

Përgjatë seancave gjyqësore, Komisioneri Publik, në mbështetje të ankimit të tij, ka kundërshtuar vendimin e Komisionit në drejtim të kriterit të vlerësimit të pasurisë, kriterit të kontrollit të figurës dhe kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, duke kërkuar nga Kolegji kryerjen e hetimeve të mëtejshme, rezultatet e të cilave mbështetën kërkimin përfundimtar të tij për një vlerësim të ndryshëm nga Komisioni të këtyre kriterëve.

Subjekti i rivlerësimit Petrit Çano ka prapësuar pretendimet e Komisionerit Publik duke analizuar në mbështetje të këtyre prapësimeve, provat e paraqitura prej tij e të administruara prej Kolegjit përgjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes.

11. Në përgjigje të kërtimeve të Komisionerit Publik, kërkit të subjektit të rivlerësimit dhe nevojave të veta për hetime të mëtejshme lidhur me kriterin e aftësive profesionale, mbështetur në parashikimet e nenit F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 41, pika 4; 43, pika 4 dhe 45 të ligjit nr. 84/2016, Kolegji çeli hetimin gjyqësor duke kryer veprimtarinë hetimore, e cila u përmbyll me marrjen me cilësinë e provës të akteve të përcjella në Kolegj prej institucioneve shtetërore dhe atyre të dorëzuara nga vetë subjekti. Kolegji vlerësoi shkaqet e ngritura në ankim dhe pretendimet përfundimtare të Komisionerit Publik duke analizuar e çmuar të gjitha provat që gjenden në fashikullin e hetimit të krijuar nga Komisioni, si dhe ato të cilat u morën gjatë procesit gjyqësor dhe iu nënshtuan debatit gjyqësor prej palëve.

12. Në Kolegj, gjatë gjykimit të kësaj çështjeje, u administruan denoncime të depozituara nga denoncuesit R. Sh.<sup>8</sup> dhe N. Ll.<sup>9</sup>. Në kushtet kur në denoncimin e z. R. Sh. ngriheshin dyshime për pasuri të fshehur të subjektit të rivlerësimit, të llojit shtëpi banimi në vendin e tij të origjinës, në {\*\*\*}, Gjirokastrë dhe në Lushnjë e Vlorë, Kolegji vlerësoi që ai përmbante informacione që duheshin verifikuar në kuptim të kriterëve të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016 dhe, për këtë arsye, vendosi që këtë denonconim t'ia nënshtrojë hetimit gjyqësor. Meqenëse në fashikullin e krijuar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, gjendeshin të administruara përgjigjet e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (në vijim "AShK"), zyra vendore Vlorë dhe Lushnjë, të cilat përcillnin informacionin se në emër të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes e vajzës së tij nuk ekzistonin pasuri të paluajtshme të regjistruara në regjistrat publikë dhe as aplikime për legalizim objekti pranë këtyre zyrave, Kolegji vlerësoi si të panevojshme kryerjen e hetimeve të mëtejshme për pasuri të fshehur në këto dy qytete. Për sa më sipër, me qëllim hetimin e plotë të këtij denoncimi, Kolegji kërkoi nga Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gjirokastrë, e cila ishte zyra që nuk kishte përcjellë informacione për pasuritë e paluajtshme të subjektit, nëse ekzistojnë në regjistrat e kësaj zyre, pasuri të paluajtshme apo aplikime për legalizim të regjistruara në emër të subjektit të rivlerësimit, të bashkëshortes M. Ç. dhe vajzës së tij A. Ç.. Lidhur me këtë

---

<sup>8</sup> I protokolluar në Kolegje nr. {\*\*\*} prot., datë 30.08.2019.

<sup>9</sup> Ky denoncues ka nisur dy denoncime, të administruara në Kolegj me nr. {\*\*\*} prot., datë 05.07.2021, si dhe një denoncim tjetër për të njëjtën problematikë që ka të bëjë me ndërtimin e një objekti në Krujë, i cili i është drejtuar nga denoncuesi ONM-së, regjistruar pranë saj me nr. {\*\*\*} prot., datë 23.07.2021, dhe i përcjellë Kolegjit, i regjistruar me nr. {\*\*\*} prot., datë 28.07.2021.

kërkesë, zyra vendore e AShK-së Gjirokastrë<sup>10</sup> i bëri me dije Kolegjit se nuk eksitojnë pasuri të paluajtshme të regjistruara në emër të Petrit Çano, M. Ç. e A. Ç.. Të njëjtin konfirmim kanë dhënë gjithashtu edhe zyrat vendore të Ujësjetës Kanalizimeve Gjirokastrë<sup>11</sup>, Vlorë<sup>12</sup> e Lushnjë<sup>13</sup>, duke konfirmuar se pranë tyre nuk ka kontrata të lidhura nga këta shtetas për furnizimin me ujë. Kolegji nuk kreu hetime të mëtejshme për sa u përket kontratave të mundshme për furnizimin me energji elektrike, duke qenë se përgjatë hetimit administrativ në Komision, ishte administruar shkresa nr. {\*\*\*}, datë 27.09.2018, prej OSHEE-së, si një institucion që disponon një databazë të centralizuar për të gjithë operatorët vendorë, nga e cila ka rezultuar se ky ent kishte kontrata të lidhura me subjektin e rivlerësimit dhe personin e lidhur, vajzën e tij, për dy pasuri të ndodhura në Tiranë, të cilat korrespondojnë me pasuritë e deklaruara prej subjektit të rivlerësimit.

13. Në këto kushte, Kolegji e konsideroi të mbyllur hetimin gjyqësor lidhur me këtë denoncim dhe, duke mos pasur indicie të tjera përtej atyre të cituara e të verifikuara si më lart, vlerësoi se informacioni i përcjellë me anë të këtij denoncimi, nuk u mbështet në asnjë fakt që buronte nga ndonjë dokument ligjor apo që të përftohej nga ndonjë burim prove i njohur nga ligji, për pasojë ai nuk mund të ndikojë në procesin e rivlerësimit për subjektin Petrit Çano.

13.1 Lidhur me denoncimin e paraqitur nga shtetasi N. Ll., Kolegji e vlerësoi atë pasi mori edhe qëndrimin e palëve lidhur me faktet që prezantoheshin në të. Denoncuesi pretendonte në denoncim se subjekti i rivlerësimit përgjatë ushtrimit të detyrës si drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, ka kryer veprime arbitrare dhe i ka kërkuar favore për shtetas të tretë, duke e shantazhuar denoncuesin për përfitime personale.

13.2 Subjekti i rivlerësimit, lidhur me denoncimin e shtetasit N. Ll., pretendoi se ai është bërë prej një individi ndaj të cilit është regjistruar dhe po ndiqet një procedim penal në prokurorinë që ai drejton dhe se denoncimi mbështetet pikërisht në motivet hakmarrëse ndaj punës së tij si drejtues. Subjekti i rivlerësimit iu përgjigj edhe pyetjeve të vëzhguesit ndërkombëtar lidhur me faktet e pretenduara se kanë ndodhur sipas denoncimit, si edhe paraqiti prova që provonin deklaratimet e tij rreth referimeve dhe kallëzimeve të depozituara ndaj denoncuesit e që po trajtohen nga zyra e prokurorisë që subjekti drejton.

Kolegji pasi vlerësoi në disa faza procedurale të procesit, denoncimin/denoncimet e paraqitura nga shtetasi N. Ll., si edhe u bind për vërtetësinë e fakteve procedurale penale që kishin lidhje me procedimin ndaj tij, çmoi se informacioni i përcjellë nëpërmjet tij/tyre, nuk plotësonte kriteret e besueshmërisë dhe objektivitetit, sipas parashikimit të nenit 53 të ligjit 84/2016, për pasojë vendosi të mos e hetojë atë.

## **B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit nga Kolegji**

### ***i. Lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë***

14. Lidhur me shkakun e ankimit, sipas të cilit procesi i hetimit i kryer nga Komisioni për kriterin e vlerësimit të pasurisë, nuk ka qenë i plotë e, për rrjedhojë, përfundimet e arritura nuk janë të pajtueshme me provat e administruara, duke pretenduar se Komisioni për pasurinë e subjektit të rivlerësimit, apartament me nr. pasurie {\*\*\*}, volumi {\*\*\*}, faqe {\*\*\*}, Zona Kadastrale {\*\*\*}, sip. 102,6 m<sup>2</sup>, në rr. “{\*\*\*}” (ndryshuar në rr. “{\*\*\*}”), shk. {\*\*\*}, ap. {\*\*\*}, Tiranë, nuk ka kryer një hetim administrativ e shterues në 3 drejtime kryesore që kanë të bëjnë me: (i) konfliktin

<sup>10</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 20.05.2021.

<sup>11</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 26.05.2021.

<sup>12</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 21.05.2021.

<sup>13</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 20.05.2021.

e interesit; (ii) veprimet në dukje fiktive; (iii) burimin e ligjshëm të të ardhurave të deklaruara se kanë shërbyer për blerjen e saj, Kolegji analizon sa vijon.

14.1 Nga aktet e administruara përgjatë hetimit administrativ, rezulton se për apartamentin me sip. 102,6 m<sup>2</sup>, të ndodhur në rrugën “{\*\*\*}” Tiranë, blerë për një vlerë prej 7.500.000 lekësh, subjekti i rivlerësimit ka hyrë në një marrëdhënie me palën shitëse Q. B., që në vitin 2006, e cila është zhvilluar më pas në vitet 2007 e 2008, duke gjetur pasqyrim ky vullnet i palëve në 3 (tri) kontrata huaje të nënshkruara respektivisht në këto tri vite. Sipas përmbajtjes së këtyre kontratave, rezulton se subjekti ka kryer pagesa në *cash*, me qëllim blerjen në të ardhmen e një apartamenti që ky individ do e përfitonte nga ndërtimi që do të kryhej në truallin në pronësi të tij. Këto kontrata rezulton të jenë deklaruar nga subjekti në deklaratimet periodike<sup>14</sup> vjetore të pasurisë.

14.2 Marrëdhënia e subjektit me palën shitëse është finalizuar formalisht me nënshkrimin e kontratës së shitblerjes nr. {\*\*\*} rep., e nr. {\*\*\*} kol., të datës 09.12.2011, me anë të së cilës është kryer kalimi i pronësisë nga shitësi te subjekti i rivlerësimit, për apartamentin e përshkruar më lart. Vlera e kësaj pasurie është përcaktuar të jetë 7.500.000 lekë dhe, sipas deklaratimeve të subjektit, përbëhet nga shumat e paguara prej tij në vitet 2006, 2007 e 2008 dhe shuma prej 500.000 lekësh paguar në kohën e lidhjes së kontratës.

14.3 Komisioneri Publik, duke pasur në konsideratë vlerën e ulët të blerjes së kësaj pasurie prej subjektit të rivlerësimit, krahasuar me vlerën që ajo kishte sipas tarifave të udhëzimit nr. 9, datë 26.2.2008, “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pronësisë së paluajtshme”, i ndryshuar, në kohën e kryerjes së veprimit juridik për kalimin e pronësisë, ka pretenduar se Kolegji duhet të hetojë rreth verifikimit të ndonjë situatë të mundshme të konfliktit të interesit mes subjektit dhe shitësve të pronës (Q. B. dhe A. B.), konflikt i cili mund të kishte kushtëzuar shitjen e pronës në kushte të favorshme për subjektin. Rezulton se Komisioni ka kryer në këtë drejtim një hetim të kufizuar, sipas pretendimit të Komisionerit, i fokusuar rreth periudhës së hartimit të kontratës, vitit 2011, dhe institucionit ku subjekti ka ushtruar funksionet në këto kohë, për pasojë Kolegji duhet të hetojë në këtë drejtim në mënyrë të plotë.

14.4 Në përgjigje të këtij pretendimi të Komisionerit Publik, Kolegji administroi me cilësinë e provës, vërtetime të lëshuara nga të gjitha zyrat e prokurorive në të cilat subjekti i rivlerësimit ka ushtruar funksionet e prokurorit, si edhe nga Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Tiranë, akte të sjella prej subjektit para trupit gjykues, por edhe nga institucionet përkatëse, në zbatim të vendimit të ndërmjetëm të trupit gjykues për marrjen e tyre<sup>15</sup>.

---

<sup>14</sup> Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006, nga subjekti i rivlerësimit, në rubrikën e të dhënave konfidenciale, që nuk publikohen, është deklaruar dhënia e një huaje në shumën 2.000.000 lekë shtetasit Q. B., banues në Tiranë, sipas kontratës së huas me nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., të datës 29.12.2006.

Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007, nga subjekti i rivlerësimit, në rubrikën e të dhënave konfidenciale, që nuk publikohen, është deklaruar dhënia e një huaje në shumën 2.000.000 lekë shtetasit Q. B., banues në Tiranë, sipas kontratës së huas me nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., të datës 19.12.2007.

Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2008, nga subjekti i rivlerësimit, në rubrikën e të dhënave konfidenciale, që nuk publikohen, është deklaruar dhënia e një huaje në shumën 3.000.000 lekë shtetasit Q. B., banues në Tiranë, sipas kontratës së huas me nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., të datës 13.12.2008.

<sup>15</sup> *Shkresa e Prokurorisë pranë Rrethit Gjyqësor Vlorë me nr. {\*\*\*} prot., datë 26.10.2018.*

*Shkresa e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat, me nr. {\*\*\*} prot., datë 24.07.2020.*

*Shkresa e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë, me nr. {\*\*\*} prot., datë 23.07.2020.*

*Shkresa e Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Tiranë, me nr. {\*\*\*} prot., datë 23.03.2021.*



14.5 Nga verifikimi i këtyre akteve, krahas vërtetimit të administruar nga Komisioni prej Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, Kolegji konstatoi se nga përmbajtja e tyre, rezultonte se në asnjë prej zyrave të prokurorisë në të cilat subjekti kishte ushtruar në gjithë vitet e tij të karrierës funksionet e prokurorit, dhe as në Prokurorinë e Posaçme Kundër Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit nuk ishte regjistruar në asnjë moment ndonjë material kallëzues apo çështje penale, në të cilat shitësit Q. B. e A. B. të kishin qenë në rolin e ndonjë subjekti procedural, sipas parashikimit të Kodit të Procedurës Penale. Në këto kushte, Kolegji, ashtu si edhe vetë Komisioneri Publik në konkluzionet e tij përfundimtare, arriti në konkluzionin se, për sa kohë që këta shtetas nuk kishin pasur asnjëherë ndonjë përfshirje në ndonjë çështje penale në çfarëdo roli procedural, në prokuroritë në të cilat ka ushtruar funksionet subjekti i rivlerësimit dhe as rezultoi ndonjë e dhënë nga ndonjë burim tjetër në këtë drejtim, mundësia e ekzistencës së një konflikti interesi të subjektit të rivlerësimit me ushtrimin e detyrës, rezultoi të mbetet e paprovuar, në konsideratë të situatës faktike dhe parashikimeve të nenit 17 të Kodit të Procedurës Penale, si edhe në kuptim të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar (në vijim “ligji nr. 9367/2005”).

14.6 Komisioneri Publik në ankim, lidhur me të njëjtën pasuri, ka ngritur pretendime për hetime të mëtejshme në funksion të verifikimit të vërtetësisë së çmimit të shitjes së kësaj pasurie, duke hedhur dyshime për veprime në dukje fiktive në këtë drejtim. Në kuadër të këtij shkak, Komisioneri ka evidentuar se, sipas kartelës së pasurisë së paluajtshme për pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 102 m<sup>2</sup>, më datë 05.07.2011, rezultoi se më datë 09.12.2011, para lidhjes së kontratës së shitblerjes me subjektin e rivlerësimit, nga ana e shitësit Q. B. është paguar detyrimi tatimor pas rivlerësimit të pronës, në zbatim të ligjit nr. 10418, datë 21.04.2011, “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor”. Sipas pretendimit të Komisionerit Publik, në zbatim të këtij procesi, pasuria është rivlerësuar në vlerën 17.955.000 lekë, ndërkohë që ajo është shitur pak muaj më vonë me vlerën 7.500.000 lekë, rreth 60% më lirë se vlera e saj sipas rivlerësimit. Kjo rrethanë duhej të shërbente si indicie për Komisionin për të hetuar në mënyrë më të plotë në drejtim të veprimeve fiktive në dukje, me qëllim për të mbuluar pamundësinë financiare nga burime të ligjshme të subjektit të rivlerësimit, për të blerë këtë pasuri me çmimin real të saj.

14.7 Nga aktet e fashikullit të krijuar nga Komisioni përgjatë hetimit administrativ, rezultoi se lidhur me pagesën e detyrimit tatimor, si pasojë e rivlerësimit të kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit në përgjigjet e pyetësorit të datës 29.10.2018, ka shpjeguar se: *Rivlerësimi është kryer në kohën që apartamenti ka qenë akoma në pronësi të shtetasit Q. B. dhe është kryer nga ai vetë për interes të tij, në kuadër të lehtësirave që krijonte ligji nr. 10418, datë 21.04.2011, "Për Legalizimin e Kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor", neni 27, në lidhje me detyrimet tatimore në bazë të të cilit ulej në mënyrë të ndjeshme taksa e kalimit të pronësisë. Çmimi i shitjes është fiksuar që më parë në marrëveshje mes palëve, nisur nga fakti që ai ishte pronar i truallit dhe në këtë truall kishte filluar të ndërtohej. Pagesat për blerjen e apartamentit kanë filluar që nga viti 2006 dhe në vazhdim, sipas kontratave të huadhënies të përmendura më lart.*

14.8 Në analizë të këtij pretendimi të Komisionerit Publik dhe të deklarimeve të subjektit në deklaratat e interesave privatë periodikë vjetorë (në vijim “DV-Periodike”) dhe përgjatë hetimit administrativ, rezultoi se marrëdhënia e subjektit me shtetasin Q. B. daton që në vitin 2006, me lidhjen e një kontrate noteriale për dhënie huaje prej 2.000.0000 lekësh (pa interes) nga subjekti për shtetasin Q. B., me qëllim blerjen e një sendi të ardhshëm (apartament banimi) në truallin e palës huamarrëse, me afat deri në legalizimin e kontratës definitive të shitblerjes së kësaj pasurie. Kjo marrëdhënie ka vijuar e tillë edhe në vitet në vijim dhe rezultoi se subjekti, sipas kontratave të huave, i ka paguar Q. B. për vitin 2007, shumën 2.000.000 lekë të tjera, ndërsa në vitin 2008 ka bërë një pagesë prej 3.000.000 lekësh. Kjo marrëdhënie është konkluduar në vitin 2011, me lidhjen

e kontratës së shitblerjes së apartamentit me sipërfaqe 102 m<sup>2</sup> në Tiranë, për të cilën në këtë vit subjekti ka paguar edhe vlerën prej 500.000 lekësh. Këto pagesa janë deklaruar prej subjektit në DV-Periodike të viteve 2006, 2007, 2008 dhe të vitit 2011, në të cilin është finalizuar kontrata e shitblerjes.

**14.9** Nga aktet e administruara në fashikull, përveç sa më lart, rezulton se situata faktike lidhur me veprimet e kryera prej palëve deri në kalimin e pronësisë së kësaj pasurie te subjekti i rivlerësimit, paraqitet si vijon.

- Shitësi i apartamentit Q. B., apartamentin prej 102 m<sup>2</sup> e ka përfutuar nëpërmjet një kontrate shkëmbimi, në cilësinë e pronarit të trullit, të lidhur ndërmjet tij dhe kompanisë ndërtuese.
- Nga të dhënat e kartelës së pasurisë së paluajtshme të apartamentit 102 m<sup>2</sup>, në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, rezulton se më datë 05.07.2011, është bërë rivlerësimi<sup>16</sup> i kësaj pasurie në vlerën 17.955.000 lekë.
- Në datën 09.12.2011, ndërmjet subjektit të rivlerësimit në cilësinë e blerësit dhe Q. B. në cilësinë e shitësit, pranë noterit, është lidhur kontrata e shitblerjes nr. {\*\*\*} rep., e nr. {\*\*\*} kol., së një apartamenti prej 102 m<sup>2</sup> në Tiranë, me vlerë 7.500.000 lekë, për të cilin palët deklarojnë se detyrimi për pagimin e tatimit mbi kalimin e pronësisë në masën 10% të vlerës së shitjes do të shlyhet nga shitësi. Në këtë kontratë, pala shitëse deklaron gjithashtu se apartamentin objekt i kësaj kontrate, ia shet blerësit kundrejt çmimit total të rënë dakord ndërmjet tyre, prej 7.500.000 lekësh, shumë e cila, siç deklarojnë vetë palët, i është likuiduar totalisht shitësit nga ana e blerësit. Blerësi deklaron se e ka pranuar pasurinë në gjendjen në të cilën ndodhet.
- Në kushtet kur shitësi, para shitjes së pasurisë apartament me sip. 102 m<sup>2</sup>, në Tiranë, më datë 09.12.2011, kishte kryer rivlerësimin e saj (në datën 05.07.2011), dhe nga shitblerja nuk rezultonte që shitësi të kishte përfutuar një çmim më të madh se ai i rivlerësimit të kësaj prone, bazuar në Kreun III “Rivlerësim i pasurive të paluajtshme”, pika 1.4/b e udhëzimit të ministrit të Financave nr. 12, datë 18.05.2011, prej tij nuk është paguar tatim për këtë transaksion shitblerjeje.

**14.10** Nga aktet e përcjella Kolegjit nga ASHK<sup>17</sup> për apartamentin me sip. 102,6 m<sup>2</sup>, në Tiranë, rezultoi se kjo pasuri, në momentin fillestar të regjistrimit, ishte regjistruar në regjistrat publikë në emër të shoqërisë ndërtuese “{\*\*\*}” ShPK, e cila, për këtë apartament, kishte lidhur kontratë shkëmbimi me z. Q. B., si pronar i trullit. Në këto kushte, kalimi i pronësisë së apartamentit nga shoqëria ndërtuese te pronari i trullit, z. B., ishte bërë në bazë të një kontrate shkëmbimi, pa përcaktuar në të një vlerë për apartamentin. Për pasojë, edhe regjistrimi i pronës në emër të pronarit të trullit ishte bërë pa përcaktuar një vlerë korresponduese të saj për llogari të regjistrimit të pronës. Gjithashtu, nga praktika e sjellë nga ASHK-ja, nuk rezultoi asnjë e dhënë që dëshmon për pagimin e detyrimit tatimor për llogari të rivlerësimit të pasurisë në vitin 2011, nga subjekti i rivlerësimit.

**14.11** Kolegji, duke analizuar sa më lart, në funksion të pretendimeve të ngritura për veprime në dukje të fiktive lidhur me përcaktimin e çmimit të këtij apartamenti, konstaton se, pavarësisht se në aktet e administruara gjatë hetimit administrativ, por edhe atij gjyqësor, nuk rezultoi ndonjë e

---

<sup>16</sup> Në këtë periudhë, ka qenë në fuqi ligji nr. 10418, datë 21.4.2011, “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor”, i ndryshuar, që mundësonte rivlerësimin e pasurive të paluajtshme, i cili parashikonte se: “Tatimi i rivlerësimit të pasurisë së paluajtshme do të llogaritet 1% e diferencës midis çmimit të rivlerësimit me çmimin e blerjes së pasurisë në kontratën paraardhëse të shitblerjes. Në rastet kur pasuria e paluajtshme e regjistruar në ZVRPP nuk ka një kontratë paraardhëse shitblerjeje, tatimi i rivlerësimit të pasurisë së paluajtshme do të llogaritet sipas metodikës së përdorur në udhëzimin nr. 9, datë 26.2.2008, “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pronësisë së paluajtshme”, të ndryshuar”.

<sup>17</sup> Praktikë e sjellë nga ASHK-ja me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 31.05.2021.

dhënë që do të tregonte vlerën fillestare të regjistrimit të kësaj prone në emër të shitësit të saj, z. Q. B., referuar mënyrës së fitimit të pronësisë mbi këtë pasuri prej tij dhe akteve nënligjore në fuqi që rregullojnë dhe përcaktojnë vlerat fiskale të pasurive nën këtë regjim<sup>18</sup>, arrihet në konkluzionin se kjo pasuri duhet të jetë regjistruar fillimisht me vlerën e kostos fiskale minimale të vitit të dhënies së lejes së ndërtimit 2004<sup>19</sup>. Për këto arsye, duket *prima facie* i arsyeshëm veprimi i kryer nga ana e shitësit Q. B. për rivlerësimin e pronës, e cila ishte e destinuar të shitej, duke përfituar nga amnistia fiskale e miratuar me ligjin nr. 10 418, datë 21.4.2011, “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor”, i ndryshuar, duke qenë se çdo detyrim tatimor mbi vlerën e përfituar prej shitjes, në raport me çmimet e referencës së vendosura për qëllime fiskale, do të rëndonte financiarisht mbi palën shitëse të pasurisë.

**14.12** Kolegji analizoi të gjitha rrethanat e faktit që kanë shoqëruar transaksionin deri në lidhjen e kontratës së shitjes në këndvështrim të pretendimeve të Komisionerit Publik, por edhe të kundërshtimeve e të prapësimeve të subjektit të rivlerësimit dhe arriti në konkluzionin se marrëdhënia juridike për fitimin e pronësisë mbi këtë pasuri, ka nisur dhe është dakordësuar mes subjektit dhe shitësit Q. B. që në vitin 2006, vit në të cilin ajo është dokumentuar në kontratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., e nr. {\*\*\*} kol., datë 29.12.2006, është deklaruar në deklaratën periodike vjetore të këtij viti dhe ka filluar pagesa e shumës së dakordësuar për blerjen e kësaj pasurie. Fakti se çmimi i përcaktuar në kontratën e shitblerjes të datës 09.12.2011, i cili ka qenë edhe objekt kontrolli, rezulton i shlyer në masën 93% të vlerës së tij që në vitin 2008, konform kontratave noteriale të lidhura mes palëve, por edhe sipas deklaramit të subjektit në deklaratat periodike vjetore për vitet 2006, 2007 e 2008, vlerësohet prej Kolegjit si një element që tregon se marrëdhënia juridike për shitblerjen e pasurisë në të ardhmen, edhe çmimi i blerjes së saj, janë dakordësuar që në vitin 2006 dhe se kontrata e shitjes së vitit 2011, është veprimi formal juridik i cili ka mundësuar ligjërish kalimin e të drejtave objekt i tij.

**14.13** Ky konkluzion i arritur si deduksion i një analize logjike të të gjitha fakteve, përjashton në vlerësimin e Kolegjit, referimin te vlera prej 17.955.000 lekësh, që përfaqëson çmimin e referencës i cili shërben për llogaritjen e tatimit sipas udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe të Drejtësisë nr. 9/2008, datë 26.02.2008, “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pasurisë së paluajtshme”, i ndryshuar, duke qenë se ai nuk është në përputhje me situatën e tregut, në të cilën palët kanë hyrë në marrëveshje me njëra-tjetrën për kushtet e saj që në vitin 2006. Fakti që palët kanë arritur në një marrëveshje për blerjen/shitjen e një pasurie në të ardhmen, madje pa u përcaktuar ndonjë afat për kohën, edhe në kushtet e mosevidentimit të çmimit të dakordësuar, përjashton apriori referimin te vlera e së ardhmes së panjohur, si një vlerë mbi të cilën do të duhej të gjykohej e vlerësohej vërtetësia e deklaramiteve për çmimin e pronës të shprehur në kontratën formale të shitjes së pasurisë.

**14.14** Në vijim të kësaj analize, Kolegji konsideroi edhe vlerën që do të kishte pasur kjo pasuri në zbatim të ligjit nr. 10418, datë 21.04.2011, “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor” dhe referencave ligjore, sipas të dhënave të Entit Kombëtar të

---

<sup>18</sup> Udhëzimi i përbashkët nr. 9, datë 26.02.2008, i Ministrisë së Financave dhe i Ministrisë së Drejtësisë, si dhe VKM-ja nr. 1129, datë 05.08.2008, “Për mënyrën e përcaktimit të vlerës së truallit, të vënë, nga pronarët e tij, në dispozicion të investitorëve të ndërtimit”, sipas së cilës përcaktohet se: “[...] a) Sipërfaqja e ndërtimit, në m<sup>2</sup>, që përfitojnë pronarët e truallit, përcaktohet në bazë të kontratës së shkëmbimit të pasurisë truall me ndërtesën e ngritur mbi të; b) Kosto e ndërtimit, për m<sup>2</sup>, përcaktohet në bazë të kostos minimale fiskale të ndërtimit, sipas qyteteve apo zonave brenda qyteteve”.

<sup>19</sup> Në vitin 2006, sipas të dhënave të Entit Kombëtar të Banesave, çmimi i tregut të lirë në Tiranë ishte në vlerën ishte 79 615 lekë/m<sup>2</sup>.

Banesave për tregun e lirë të apartamenteve në Tiranë<sup>20</sup>, në kohën e arritjes së marrëveshjes mes palëve për huamarrjen në vitin 2006. Sipas këtyre të dhënave, rezultoi se vlera që apartamenti do të kishte në kohën e arritjes së marrëveshjes, do të ishte 8.120.730 lekë, pra ajo rezulton se është e përafërt me vlerën e çmimit të përcaktuar nga palët në kontratën e shitjes objekt verifikimi dhe arsyeshme, konsideruar marrëdhëniet e miqësisë të deklaruar mes tyre.

**14.15** Duke arsyetuar si më lart, edhe në konsideratë të konkluzionit të arritur më sipër, se subjekti nuk u provua se gjendej në kushtet e të konfliktit të interesit në raport me palën shitëse, Kolegji arriti në përfundimin se nga analiza e fakteve në harmoni me dispozitat ligjore në fuqi, nuk mund të konkludohej se çmimi i vendosur në kontratën e shitblerjes është fiktiv dhe, për pasojë, pretendimi i Komisionerit në këtë drejtim, gjendet i pambështetur në prova e fakte.

**14.16** Lidhur me pretendimin për mungesë të burimeve të ligjshme në përballimin e shpenzimeve për blerjen e kësaj pasurie, Kolegji hetoi sipas këtij shkaku ankimi në drejtim të verifikimit të ligjshmërisë dhe përcaktimit të vlerës së të ardhurave të përfituara nga aktiviteti i personit juridik shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, të cilat janë vënë në pikëpyetje për shkak të përmbajtjes së shkresës së datës 20.2.2019, përcjellë nga D.R.T Fier në ILDKPKI. Sipas këtij akti, rezulton se subjekti “{\*\*\*}” ShPK ka detyrime të papaguara, në zërin “tatimfitimi i thjeshtuar”, në shumën 110.000 lekë, për të cilën nuk pasqyrohet se cilit vit i takon. Identifikimi i vitit përkatës për të cilin janë shlyer detyrimet tatimore, sipas pretendimit të Komisionerit në ankim, ndikon në konsiderimin ose jo të së ardhurës së deklaruar si e ardhur e ligjshme, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

**14.17** Kolegji, në përgjigje të këtij pretendimi të Komisionerit Publik, me vendim të ndërmjetëm<sup>21</sup>, vendosi të kërkojë të dhëna nga administrata tatimore lidhur me: kohën së cilës i përkasin detyrimet tatimore të aktivitetit tregtar të subjektit privat, kopshti “{\*\*\*}” ShPK, me nr. NIPT {\*\*\*}, në të cilin bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. M. Ç., ka qenë ortakë e vetme, të evidentuara me praktikën bashkëlidhur shkresës së Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier nr. {\*\*\*}, datë 20.02.2019.

**14.18** Në përgjigje të kësaj kërkesë të Kolegjit, administrata tatimore, përkatësisht Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, në shkresën përkatëse<sup>22</sup>, ka shpjeguar se [...] detyrimet kanë qenë për shkak të deklaratave të padorëzuara, të cilat i përkasin periudhës 2014-2016, për detyrime pas datës së aplikimit për çregjistrim të subjektit. Në zbatim të nenit 133 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, tatimpaguesit që kanë bërë kërkesë për çregjistrim në QKB e më pas nuk kanë zhvilluar veprimtari ekonomike, por nuk kanë dorëzuar deklaratat tatimore me vlerë zero dhe, për këtë arsye, janë të evidentuar si debitorë, u falen gjat dhe interesat për këtë mosdeklarim. Në përfundim të shkresës, administrata tatimore Fier konkludon se tatimpaguesi “{\*\*\*}” ShPK nuk ka detyrime tatimore të papaguara.

**14.19** Bazuar në të dhënat e mësipërme të verifikuara në gjykim, Kolegji, ashtu si edhe Komisioneri Publik në konkluzionet përfundimtare, arriti në përfundimin se të ardhurat e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si të përfituara nga aktiviteti privat i kopshtit jopublik “{\*\*\*}” ShPK në deklaratat periodike vjetore të përdorura më pas prej tij si burim për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 102 m<sup>2</sup> në Tiranë, në pronësi të subjektit të rivlerësimit, plotësojnë kushtet për t’u konsideruar si të ardhura të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016.

<sup>20</sup> Në vitin 2006, sipas të dhënave të Entit Kombëtar të Banesave, sipas udhëzimit nr. 5, datë 07.09.2006, çmimi i tregut të lirë në Tiranë, ishte në vlerën 79 615 lekë/m<sup>2</sup>.

<sup>21</sup> Në seancën gjyqësore të datës 14.05.2021.

<sup>22</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 28.05.2021.

15. Lidhur me pretendimet e Komisionerit Publik për pasurinë apartament, me sipërfaqe 63 m<sup>2</sup>, të ndodhur në Tiranë, blerë me vlerën 53.000 euro, në pronësi të vajzës së subjektit të rivlerësimit, me të ardhurat nga kursimet e prindërve, Komisioni nuk ka kryer hetim shterues në drejtim të: (i) konfliktit të interesit; (ii) pagesës në vlerën 1.023.335 lekë në aplikimin pranë ZVRPP Tiranë; (iii) veprime në dukje fiktive; (iv) burimit të ligjshëm të të ardhurave të deklaruar nga kontrata e shitjes, në shumën 1.400.000 lekë, Kolegji i shqyrtoi ato krahas prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, duke analizuar rrethanat e faktit që rezultuan nga aktet e fashikullit të hetimit administrativ dhe ato që rezultuan nga hetimi gjyqësor i çështjes, si më poshtë.

15.1 Për pasurinë apartament, me nr. pasurie {\*\*\*}, volumi {\*\*\*}, faqe {\*\*\*}, Zona Kadastrale {\*\*\*}, adresa rr. “{\*\*\*}”, godina {\*\*\*}, hyrja {\*\*\*}, apartamenti {\*\*\*}, Tiranë, me sip. 63 m<sup>2</sup>, Komisioneri Publik, ashtu si edhe për pasurinë apartament në Tiranë me sip. 102,3 m<sup>2</sup>, të analizuar më sipër, pasi ka evidentuar se edhe çmimi i blerjes së apartamenti në pronësi të vajzës së subjektit të rivlerësimit, rezulton të jetë më i vogël se çmimi i referencës i shitjes së apartamenteve në atë zonë, ka ngritur pretendimin se prej Komisionit nuk është hetuar në drejtim të konfliktit të interesit, për të kuptuar nëse ushtrimi i detyrës nga subjekti i rivlerësimit ka ndikuar ose jo në lidhjen e një kontrate me çmime të favorshme për vajzën e tij.

15.2 Subjekti i rivlerësimit, lidhur me këtë pretendim, gjatë gjykimit në Kolegji, ka prapësuar duke deklaruar se shitëset e kësaj kontrate, *znj. M. Sh.; E. L. (Sh.); A. S. (Sh.) dhe A. I. (Sh.)*, asnjëherë nuk janë hetuar nga subjekti i rivlerësimit dhe as kanë pasur asnjëherë çështje penale të regjistruar në prokuroritë ku ai ka ushtruar funksionin. Gjithashtu, subjekti shpjegoi përgjatë gjykimit, se çmimi i shitjes së kësaj prone është i njëjtë me çmimin e shitjes së apartamenteve të tjera, me të njëjtat karakteristika në atë zonë. Për të provuar këtë pretendim, subjekti paraqiti në cilësinë e provës vërtetime të lëshuara nga Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar<sup>23</sup>, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë<sup>24</sup>, Vlorë<sup>25</sup>, Berat<sup>26</sup> dhe Tiranë<sup>27</sup>, të cilat pasqyronin faktin se për palën shitëse, nuk rezulton të jetë regjistruar ndonjë procedim penal. Për një hetim sa më të plotë të këtij pretendimi të Komisionerit Publik, Kolegji kërkoi informacion edhe nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, nëse gjatë ushtrimit të funksionit pranë kësaj prokurorie të subjekti i rivlerësimit, është regjistruar ndonjë material kallëzues, referues apo procedim penal në emër palëve shitëse të kësaj kontrate. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë<sup>28</sup>, në përgjigje të kësaj kërkesë, ktheu përgjigjen se për shtetaset e sipërcituara, në këtë prokurori nuk është regjistruar asnjë material kallëzues, referues apo procedim penal.

15.3 Kolegji konstatoi se edhe nga përmbajtja e shkresave të lëshuara nga prokuroritë e tjera, rezultonte se në asnjë prej zyrave të prokurorisë në të cilat subjekti kishte ushtruar në gjithë vitet e tij të karrierës, funksionet e prokurorit, dhe as në Prokurorinë e Posaçme Kundër Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit, nuk ishte regjistruar në asnjë moment ndonjë material kallëzues apo çështje penale, në të cilat shitëset e pasurisë në emër të vajzës së tij, shtetaset *M. Sh.; E. L. (Sh.); A. S. (Sh.) dhe A. I. (Sh.)*, të kishin qenë në rolin e ndonjë subjekti procedural sipas parashikimit të Kodit të Procedurës Penale. Në këto kushte, Kolegji, ashtu si edhe vetë Komisioneri Publik në konkluzionet e tij përfundimtare, arriti në konkluzionin se, për sa kohë që këto shtetase nuk kishin pasur asnjëherë ndonjë përfshirje në ndonjë çështje penale në çfarëdo roli procedural, në

<sup>23</sup> Nr. {\*\*\*} prot., datë 24.03.2021.

<sup>24</sup> Nr. {\*\*\*} prot., datë 23.07.2020.

<sup>25</sup> Nr. {\*\*\*} prot., datë 18.09.2020.

<sup>26</sup> Nr. {\*\*\*} prot., datë 05.02.2021.

<sup>27</sup> Nr. {\*\*\*} prot., datë 17.02.2021.

<sup>28</sup> Nr. {\*\*\*} prot., datë 26.05.2021.

prokuroritë në të cilat ka ushtruar funksionet subjekti i rivlerësimit dhe as rezultat ndonjë e dhënë nga ndonjë burim tjetër në këtë drejtim, mundësia e ekzistencës së një konflikti interesi të subjektit të rivlerësimit me ushtrimin e detyrës, rezultojnë të mbetet e paprovuar, në konsideratë të situatës faktike dhe të parashikimeve të nenit 17 të Kodit të Procedurës Penale, si edhe në kuptim të ligjit nr. 9367/2005.

**15.4** Lidhur me pretendimin tjetër të Komisionerit Publik, sipas të cilit Komisioni nuk ka kryer hetim shterues në drejtim të faktit se cili ka kryer pagesën e shumës prej 1.023.335 lekësh, për llogari të ZRVPP Tiranë, në momentin e kalimit të pronësisë së kësaj pasurie te personi tjetër i lidhur dhe pasojën që ky veprim ka në analizën financiare për njësinë familjare të subjektit, Kolegji, pasi analizoi pretendimet e palëve nën dritën e fakteve që rezultuan të provuara në gjykim, konstaton sa vijon.

**15.5** Pretendimi i mësipërm i Komisionerit mbështetet në aktin e administruar në fashikullin e Komisionit, i titulluar “Formular aplikimi për kryerje pagese” në favor të ZRVPP Tiranë, i datës 16.07.2014. Ky akt është përpiluar nga vajza e subjektit të rivlerësimit, znj. A. Ç., dhe konsiston në kërkimin për të marrë shërbimin e regjistrimit të kontratës së shitjes dhe lëshimin e certifikatës së pronësisë, si edhe të lëshimit të kopjes së kartelës së pasurisë, shërbime për të cilat ky formular aplikimi ka të identifikuar edhe tarifën përkatëse që duhen paguar. Ky formular gjithashtu në pjesën fundore të tij, rezultojnë të ketë të identifikuar shumën prej 1.017.335 lekësh, si vlerë e tatimit për kalimin e pronësisë, në masën (10%) të fitimit të realizuar nga shitja e pronës. Për shkak të faktit se kjo vlerë është e identifikuar në këtë formular aplikimi të nënshkruar nga vajza e subjektit të rivlerësimit, Komisioneri Publik e ka konsideruar këtë të dhënë si një element që tregon se tatimi mund të jetë paguar prej saj dhe, si i tillë, ky shpenzim duhet përfshirë në analizën financiare të vitit përkatës të subjektit të rivlerësimit.

**15.6** Subjekti i rivlerësimit, në seancë gjyqësore ka prapësuar pretendimin e mësipërm, duke deklaruar se ai nuk qëndron dhe është i pambështetur në ligj, për sa kohë që këtë detyrim e ka pala shitëse në një transaksion të tillë. Në mbështetje të këtij qëndrimi, subjekti i rivlerësimit paraqiti në cilësinë e provës, korrespondencën me ZRVPP, Tiranë që datonte në vitin 2019<sup>29</sup>, me anë të së cilës kishte kërkuar marrjen e praktikës së regjistrimit të apartamentit me nr. pasurie nr. {\*\*\*}, vol. {\*\*\*}, {\*\*\*}, me sipërfaqe 63 m<sup>2</sup>, në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, pjesë e së cilës ishte pagesa e tatimit mbi kalimin e pronësisë, në vlerën 1.017.335 lekë.

Sipas këtij dokumentacioni, kjo pagesë ishte kryer nëpërmjet transaksionit bankar të datës 16.07.2014, në Bankën Credins, nga përfaqësuesja e palës shitëse, njëkohësisht edhe bashkëpronare e këtij apartamenti, znj. A. L.(Sh.). Nga kjo praktikë, rezultojnë se vajza e subjektit të rivlerësimit, znj. A. Ç. të ketë kryer vetëm pagesën për 6.000 lekësh për marrjen e kopjes së kartelës së pasurisë së apartamentit 63 m<sup>2</sup>, pas regjistrimit të kontratës së shitblerjes e të marrjes së certifikatës së pronësisë për këtë pasuri.

**15.7** Kolegji, pasi analizoi përmbajtjen e akteve të paraqitura nga subjekti e të administruara me cilësinë e provës, arriti në konkluzionin se kryerja e pagesës në vlerën prej 1.017.335 lekësh, përveçse një detyrim ligjor i palës shitëse, sipas përcaktimeve të nenit 8, pika 1, shkronja “dh” e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për të ardhurat personale” i ndryshuar, provohet se edhe në fakt është paguar prej kësaj pale dhe jo nga vajza e subjektit të rivlerësimit, siç mund të supozohej në mungesë të pasjes së gjithë praktikës dokumentare të administruar në gjykim. Në këto kushte, Kolegji, ashtu si edhe vetë Komisioneri Publik duket se ka vlerësuar në konkluzionet përfundimtare, çmon se subjekti i rivlerësimit nuk mund të ngarkohet me këtë shpenzim në

---

<sup>29</sup> Praktikë e përcjellë me shkresën e ZRVPP Tiranë nr. {\*\*\*} prot., datë 17.10.2019.

analizën financiare të vitit 2014, duke qenë se ai nuk është përballuar me fonde të njësisë së tij familjare.

**15.8** Kolegji hetoi dhe shqyrtoi pretendimin e Komisionerit Publik se vlera e shitjes së pasurisë apartament, me sipërfaqe 63 m<sup>2</sup>, në Tiranë, në pronësi të personit të lidhur, prej 7.431.660 lekësh, që rezulton të jetë rreth 40% më e lirë se vlera prej 12.033.000 lekësh e përcaktuar në këtë nivel, në zbatim të udhëzimit nr. 9/2008, datë 26.02.2008, të Ministrisë së Financave dhe të Drejtësisë “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pasurisë së paluajtshme”, duhej të shërbente si indicie për Komisionin për të hetuar në mënyrë më të plotë në drejtim të veprimeve fiktive në dukje me qëllimin për të mbuluar pamundësinë financiare nga burime të ligjshme të subjektit të rivlerësimit për të blerë këtë pasuri me çmimin real të saj.

**15.9** Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi pretendimin e mësipërm të Komisionerit Publik duke paraqitur qëndrimin e tij se vlera fiskale e pasurisë dhe vlera ndërtimore e objektit janë dy koncepte të ndryshme dhe se ky objekt është përfituar me vlerë të përafërt me atë të shitjes së pasurive të tjera të paluajtshme me të njëjtat karakteristika në zonën ku ai ndodhet.

**15.10** Kolegji analizoi në vijim, aktet e paraqitura prej subjektit në mbështetje të qëndrimit kundërshtues ndaj pretendimit të Komisionerit Publik, të cilat u paraqitën prej tij në gjykim me cilësinë e provës dhe u administruan si të tilla prej Kolegjit.

**15.11** Në këto kushte, nga shqyrtimi i disa kontratave shitblerjeje<sup>30</sup> apartamentesh, me sipërfaqe të përafërt e me vendndodhje në zonën ku ndodhet apartamenti në pronësi të vajzës së subjektit, rezultoi se çmimi i shitjes së tyre përkon të jetë pothuajse i njëjtë me atë të shitjes së apartamentit në pronësi të personit të lidhur. Gjithashtu rezulton se edhe periudha kohore e kryerjes së transaksionit është në periudha jo shumë të largëta nga ajo e kryerjes së transaksionit për kalimin e pronësisë të personi i lidhur, duke e bërë të parëndësishme diferencën kohore (maksimalisht 3 (tre) vjet), në drejtim të vlerësimit dhe matjes së vlerës së përcaktuar si çmim për shitblerjen e pronës.

**15.12** Kolegji analizoi gjithashtu edhe përmbajtjen e akteve të paraqitura prej subjektit në gjykim e të administruara me cilësinë e provës, të cilat ishin lëshuar në përgjigje të kërkesës së tij nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës. Sipas përmbajtjes së shkresës “Relacion shpjegues” (për pagesë të padrejtë), të lëshuar nga AShK Tirana jug më datë 17.10.2019, për pasurinë apartament me nr. pasurie nr. {\*\*\*}, vol {\*\*\*}, {\*\*\*} me sipërfaqe 63 m<sup>2</sup>, të ndodhur në rrugën “{\*\*\*}” Tiranë, vlera e apartamentit, në bazë të vlerave fiskale të vitit 2014, nuk duhet të ishte llogaritur në vlerën 12.033.000 lekë, por 9.626.400 lekë. Kjo e dhënë, e parë në këndvështrim të pretendimit të Komisionerit Publik për diferencën mes çmimit të shitjes së pasurisë dhe vlerës fiskale të saj në momentin e kryerjes së transaksionit, e zvogëlon këtë diferencë, pavarësisht arsyetimit në vijim mbi rrethanat e tjera faktike që u konsideruan prej trupit gjykues, në funksion të analizimit të këtij shkaku ankimi.

---

<sup>30</sup> Kontrata për shitblerje apartamentesh, të paraqitura në cilësinë e provës në seancën gjyqësore të datës 27.04.2021, në Kolegji, nga subjekti i rivlerësimit janë:

- Kontrata e shitblerjes me nr. {\*\*\*} rep., e nr. {\*\*\*} kol., e datës 06.06.2017, për apartament me sip. 58 m<sup>2</sup>, në rrugën “{\*\*\*}” Tiranë, me vlerë 62.500 euro.
- Kontrata e shitblerjes me nr. {\*\*\*} rep., e nr. {\*\*\*} kol., e datës 09.04.2015, për apartament me sip. 66 m<sup>2</sup>, në rrugën “{\*\*\*}” Tiranë, me vlerë 53.000 euro.
- Kontrata e shitblerjes me nr. {\*\*\*} rep., e nr. {\*\*\*} kol., e datës 03.02.2017, për apartament me sip. 58 m<sup>2</sup>, në rrugën “{\*\*\*}” Tiranë, me vlerë 48.175 euro.

**15.13** Nga dokumenti “Raport vlerësimi” (tekniko-ekonomik) për pasurinë me nr. {\*\*\*}, vol. {\*\*\*}, {\*\*\*}, të hartuar nga eksperti vlerësues ing. M. H. në dhjetor 2020 e të përcjellë prej subjektit e administruar nga trupi gjykues, rezultojnë disa të dhëna teknike që lidhen me pasurinë e mësipërme, të cilat tregojnë për situatën faktike të saj në momentin e kryerjes së transaksionit e më pas, e që konsistojnë në një vlerësim të gjendjes fizike të pronës, i kryer nga verifikimi në vend i saj, si edhe një vlerësim të vlerës së saj në treg duke iu referuar normave të amortizimit e referencave të standardet ligjore të vlerësimit. Sipas këtij vlerësimi, i cili është një mënyrë alternative e vlerësimit të pasurive të paluajtshme<sup>31</sup>, në zbatim të nenit 27, paragrafi 2<sup>32</sup> i ligjit nr. 10418, datë 21.04.2011, “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor”, kjo pasuri është vlerësuar të këtë në treg për afërsisht vlerën prej 2.562.684 lekësh, në konsideratë të të gjithë treguesve të përmendur më lart. Përveç sa më lart, nga praktika e hartuar nga Enti Kombëtar i Banesave në vitin 1993, në funksion të privatizimit të kësaj pasurie nga pala shitëse, familja e A. Sh., si dhe nga kontrata për privatizim të kësaj banese e datës 01.04.1993, rezulton se ky apartament është ndërtuar në vitin 1962.

**15.14** Për të arritur një konkluzion në lidhje me çështjen e mësipërme, Kolegji mori në konsideratë në analizën e tij, elementet si vijojnë: **(i)** vitin e ndërtimit të objektit në të cilin ndodhet pasuria (që daton në vitin 1962); **(ii)** faktin e mungesës së investimeve të rëndësishme në këtë pasuri në kohën e blerjes së saj; **(iii)** normat ligjore të amortizimit që ndikojnë në përcaktimin e vlerës së pasurisë; **(iv)** parashikimin ligjor të nenit 27 të ligjit nr. 10418, datë 21.04.2011, “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor”, që lejon vlerësimin e dedikuar, me ekspert vlerësues të pasurive të paluajtshme, të një pasurie, në varësi të rrethanave konkrete që e shoqërojnë atë; **(v)** vlerësimin e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për një vlerë më të ulët reference për këtë pasuri, si edhe çmimet e përafërta të shitjes së pasurive me karakteristika të ngjashme në të njëjtën zonë.

Në konsideratë të gjithë këtyre fakteve, Kolegji arriti në konkluzionin se çmimi i referencës i përcaktuar sipas udhëzimit nr. 9/2008, datë 26.02.2008, të Ministrisë së Financave dhe të Drejtësisë “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pasurisë së paluajtshme”, nuk është relevant në rastin konkret, për sa kohë që çmimi i përcaktuar sipas një mënyre alternative vlerësimi të parashikuar gjithashtu nga përcaktimet e vetë ligjit nr. 10418/2011 dhe që gjen zbatim në rrethanat faktike konkrete, referon në vlera të ndryshme të cilat çbëjnë vetë bazën ligjore mbi të cilën mbështetet pretendimi i Komisionerit. Gjithashtu, ekzistojnë një sërë rrethanash, përfshirë edhe mungesën e kushteve të konfliktit të interesit, të cilat nuk mbështetin konkluzionin se çmimi i vendosur në kontratë është fiktiv, prandaj pretendimi i Komisionerit Publik në këtë drejtim, u vlerësua se nuk është i mbështetur në prova e në ligj.

- 16.** Kolegji mori në shqyrtim edhe pretendimin e Komisionerit Publik, sipas të cilit Komisioni nuk ka kryer hetim shterues në drejtim të verifikimit të burimit të ligjshëm të të ardhurave të deklaruara nga kontrata e shitjes së pajisjeve të kopshtit privat “{\*\*\*}” ShPK, në shumën 1.400.000 lekë, të cilat janë përdorur për financimin e çmimit të apartamentit në pronësi të personit të lidhur. Nga analizimi i akteve të fashikullit të krijuar në Komision, si dhe i deklaratave periodike të pasurisë, rezulton se me anë të një kontrate noteriale shitblerjeje nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., të datës 17.10.2010, bashkëshortja e subjektit ka shitur pajisjet e kopshtit jopublik “{\*\*\*}” ShPK, tek i cili ajo ishte administratore dhe ortake e vetme me vlerën 1.400.000 lekë, e ardhur e cila është deklaruar nga subjekti edhe në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010. Komisioni e ka

---

<sup>31</sup> Pasi, si mënyra më e përdorur për rivlerësimin e pasurive, është aplikimi nga zyrat vendore të regjistrimit të pasurisë e vlerave fiskale të pasurisë. Vlerësimi i pasurisë me ekspert të pavarur kryhet duke u bazuar në të dhënat, si: viti i ndërtimit, amortizimi, investimi i kryer ndër vite për mirëmbajtjen e tyre etj.

<sup>32</sup> Ky rivlerësim mund të bëhet nga një ekspert i licencuar për vlerësimin e pasurisë së paluajtshme nga institucionet përkatëse ose nga zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme.



konsideruar këtë shumë si të ardhur të ligjshme dhe e ka llogaritur si të tillë në analizën financiare që është bërë për verifikimin e burimeve të ligjshme të subjektit për blerjen e pasurisë në emër të vajzës së tij.

**16.1** Komisioneri Publik në ankim, si dhe përgjatë gjykimit, ka pretenduar se nga hetimi administrativ i Komisionit, edhe pse është evidentuar fakti që shitja e pajisjeve nuk është bërë nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, por nga znj. M. Ç. si individ, është hetuar dhe vlerësuar vetëm fakti nëse bashkëshortja e subjektit ka pasur detyrim të paguajë tatim për shumën e përfituar nga shitja e aseteve në vitin 2010, pa vlerësuar se e ardhura e përfituar nga kontrata e shitjes së pajisjeve nga bashkëshortja e subjektit në tetor të vitit 2010, duhej konsideruar ose jo si një e ardhur e ligjshme lidhur me kualifikimin e burimit të krijimit të saj, si një titull/veprim juridik i ligjshëm, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

**16.2** Sipas Komisionerit Publik, shumata e përfituar nga shitja e aseteve të kopshtit “{\*\*\*}” ShPK arsyetohet se: [...] *Në analizë të rrethanave dhe fakteve të mësipërme, në raport me përcaktimet e ligjit nr. 9901/2008 “Për shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, ligjshmëria dhe efektet juridike që kanë rrjedhur nga veprimi juridik, kontrata e shitjes së aseteve të shoqërisë, e tetorit 2010, vihet në diskutim lidhur me ligjshmërinë e veprimit juridik që e ka krijuar atë, për sa kohë ky veprim është kryer nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, si administratore e shoqërisë, ndërkohë që shoqëria ishte në statusin “në likuidim e sipër” dhe veprimet duhet të kryheshin prej likuidatores të caktuar, për pasojë ky veprim vjen në kundërshtim me nenet 196/1 dhe 197/1, të ligjit nr. 9901/2008 “Për shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, dhe afekton ligjshmërinë e burimit të këtyre të ardhurave.*

Përt’i dhënë përgjigje këtij shkaku ankimi të Komisionerit Publik, Kolegji çmoi se duhet të marrin përgjigje kronologjikisht çështjet e mëposhtme.

- i. Cila do të jetë shumata e cila do t’i nënshtrohet këtij vlerësimi për verifikimin e burimeve të ligjshme?
- ii. Si do të konsiderohet pasoja ligjore e krijuar nga shitja prej personit të lidhur, e aseteve të shoqërisë, në vlerën e përcaktuar në pikën pararendëse?
- iii. Në një vlerësim të përgjithshëm, në kuptim të kërkesave të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016, si do të konsiderohen të ardhurat e krijuara me burim kontratën e shitjes së aseteve?

**16.3** Lidhur me çështjen e parë të shtruar për zgjidhje, Kolegji vlerëson të analizojë të dhënat që janë përfutuar gjatë procesit të hetimit administrativ e të cilat përcaktojnë regjimin e krijimit të aseteve të kopshtit “{\*\*\*}” ShPK, në të cilin bashkëshortja e subjektit ishte ortak e vetme dhe administratore e tij. Nga këto të dhëna, rezulton se aktiviteti tregtar i kopshtit “{\*\*\*}” ShPK në Fier ka nisur bazuar në ligjin nr. 7638, datë 11.10.1992, “Për shoqëritë tregtare” dhe ligjin nr. 7667, datë 28.01.1993, “Për regjistrat tregtarë”, sipas vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë të datës 29.06.2004, “Për regjistrimin e personit juridik” kopsht “{\*\*\*}” ShPK.

**16.4** Rezulton se, me themelimin e shoqërisë së përshkruar më lart, personi i lidhur si ortak e vetme e saj, ka kontribuar me fonde të njësisë familjare për të mundësuar pajisjen e objektit ku do të ushtrohej aktiviteti për të cilin ishte themeluar shoqëria, si edhe vetë nisjen e këtij aktiviteti, për një pjesë të mjeteve të nevojshme për ushtrimin e tij. Referuar deklaratimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit përgjatë hetimit administrativ, por edhe në prapësimet e tij në gjykim, rezulton se një pjesë e pajisjeve janë financuar me fondet e familjes, në vlerën 800.000 lekë përkatësisht në vitet 2004 e 2005, shumë e cila rezulton të jetë përfshirë si shpenzim në analizën financiare të ekonomisë familjare të kryer nga Komisioni për këto vite. Ndërsa për pjesën tjetër të pajisjeve në vlerën prej 600.000 lekësh, është deklaruar se është investuar prej personit të lidhur

përkatësisht në vitet 2006, 2008 e 2009 me të ardhurat e realizuara nga aktiviteti i kopshtit “{\*\*\*}” ShPK, për të cilat aktualisht nuk disponon fatura, pasi ato nuk janë ruajtur për shkak të kohës së largët që ka kaluar<sup>33</sup>.

**16.5** Në analizë të kësaj situatë faktike, mbështetur në deklaratimet e subjektit si të vetmet burime informacioni për shpenzimet e kryera, Kolegji konstaton se një pjesë e pajisjeve të cilat janë shitur prej bashkëshortes së subjektit në vitin 2010, në vlerën prej 800.000 lekësh, janë përballuar si shpenzim nga njësi familjare e subjektit e si të tilla edhe janë ngarkuar në analizën financiare të kryer për të për vitet 2004 e 2005. Në vijim të arsyetimit të ngritur mbi këtë situatë faktike, Kolegji arrin në konkluzionin se fakti që subjekti dhe personi i lidhur kanë vënë në dispozicion të aktivitetit të kopshtit “{\*\*\*}” ShPK, pajisjet e blera me të ardhura të njësisë familjare, të cilat nuk rezultojnë se janë kapitalizuar për llogari të shoqërisë, përfaqëson një marrëdhënie përdorimi të shoqërisë mbi këto pajisje, por pa zhveshur subjektin dhe personin e lidhur nga pronësia mbi to, pikërisht për shkak të faktit se ato janë krijuar me të ardhurat e tyre personale.

**16.6** Për këto arsye, trupi gjykues çmon se subjekti dhe personi i lidhur, duke u konsideruar si pronarë të ligjshëm të pajisjeve të vëna në dispozicion të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, deri në vlerën prej 800.000 lekësh, kanë pasur të drejtë të disponojnë mbi to duke tjetërsuar ata vetë të drejtat e tyre të pronësisë. Në këtë kuptim, Kolegji çmon se vlera e cila duhet t’i nënshtrohet vlerësimit rreth ligjshmërisë së burimit të krijimi të saj, që vjen nga kontrata e shitjes së pajisjeve të kopshtit në vitin 2014, është vetëm shuma 600.000 lekë, vlerë e cila u korrespondon shpenzimeve të përballuara me fondet e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK për blerjen e tyre, referuar deklaratimeve të vetë subjektit të rivlerësimit si më lart cituar.

**16.7** Në konkluzion të sa më sipër, Kolegji analizoi në drejtim të ligjit të zbatueshëm ligjshmërinë e transaksionit që lidhet me shitjen e pajisjeve të kopshtit jopublik “{\*\*\*}” ShPK, në pronësi të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit si ortake e vetme, duke orientuar analizën e tij në mënyrë të diferencuar për vlerën 800.000 lekë, investim dhe përfitim i gjeneruar nga njësi familjare e subjektit dhe vlerën prej 600.000 lekësh, si investim dhe përfitim i gjeneruar nga biznesi i bashkëshortes, referuar të dhënave të deklaruara gjatë hetimit në Komision e Kolegji dhe të pranuar nga palët.

**16.8** Lidhur me çështjen e dytë, Kolegji verifikoi fillimisht nëse shoqëria “{\*\*\*}” ShPK kishte mundësi të përballonte financiarisht shpenzimin e kryer në vlerën prej 600.000 lekësh përkatësisht në vitet 2006, 2008 dhe 2009, me fondet e përfituara nga aktiviteti i shoqërisë, duke konsideruar të ardhurat, shpenzimet e deklaruara dhe fitimin e llogaritur për këtë person juridik. Nga verifikimi i të dhënave të rezultuara nga të gjitha aktet e administruara si gjatë hetimit administrativ, ashtu edhe gjatë hetimit gjyqësor, Kolegjit i rezultoi se kjo shoqëri kishte mundësi financiare për të investuar në blerjen e këtyre pajisjeve në vitet e pretenduara. Për këto arsye, Kolegji përfshiu në analizë, në drejtim të vlefhtësisë të ligjshmërisë së të ardhurës së krijuar nga shitja e pajisjeve me anë të kontratës të vitit 2014, vlerën 600.000 lekë, e cila do të trajtohet si një vlerë që i korrespondon një pasurie që i përkiste shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK dhe jo subjektit apo personit të lidhur si pasuri e tyre personale.

**16.9** Në përgjigje të pretendimit të Komisionerit Publik rreth paligjshmërisë së veprimit juridik të shitjes së këtyre asetëve në vitin 2010, për shkak se ato janë shitur prej personit të lidhur me cilësinë e ortakes dhe administruarës së shoqërisë, ndërkohë që shoqëria kishte kaluar në likuidim, dhe ishte caktuar një likuidatore e ngarkuar me ligj për kryerjen e çdo veprimi në emër e për llogari

---

<sup>33</sup> Subjekti ka referuar në shpjegimet në Komision se ligji nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” kërkon ruajtjen e tyre 10 vjet nga koha kur ka ndodhur veprimi/pagesa.

të shoqërisë, Kolegji analizoi veprimin juridik të shitjes së këtyre aseteve vetëm për vlerën korresponduese prej 600.000 lekësh, në raport me kuadrin ligjor në fuqi, duke arsyetuar si vijon.

**16.10** Shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, e licencuar nga Ministria e Arsimit sipas urdhrit nr. 211, datë 01.07.2005, për të ushtruar aktivitetin si një institucion arsimor jopublik i arsimit parashkollor, sipas të dhënave të regjistrit tregtar ([www.qkb.gov.al](http://www.qkb.gov.al)), rezulton se me vendim të asamblesë të ortakëve, i përbërë nga ortakja e vetme znj. M. Ç., më datë 26.02.2010 ka kaluar në statusin “në likuidim e sipër” dhe ka emëruar likuiduesen e saj. Pas miratimit të raportit të likuidimit më datë 26.02.2019, shoqëria “{\*\*\*}” ShPK është çregjistruar nga regjistri tregtar, përkatësisht më datë 04.04.2019<sup>34</sup>, kohë në të cilën aktivitetet e shoqërive tregtare rregulloheshin sipas ligjit të ri nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për shoqëritë tregtare”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 9901/2008”).

**16.11** Sipas neneve 196/1 dhe 197/1, të ligjit nr. 9901/2008, “Për shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, ndër të tjera, përcaktohet se: “Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij”. Dhe se: “Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve [...]”, ndërsa në nenin 202 të të njëjtit ligj parashikohet se: *Pas shlyerjes së detyrimeve ndaj kreditorëve, likuiduesi u shpërndan ortakëve apo aksionarëve aktivet e mbetura, sipas të drejtave që ata kanë në ndarjen e fitimeve, me përjashtim të rastit kur statuti parashikon radhë preference.*

**16.12** Në referencë të parashikimeve si më sipër dhe të dhënave të ekstraktit historik të regjistrit tregtar të QKB-së<sup>35</sup>, tek e cila rezulton se shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, më datë 26.02.2010, ka përcaktuar *likuiduesen*<sup>36</sup> dhe ka kaluar në statusin “në likuidim e sipër”, konstatohet se në kohën që është kryer kontrata e shitjes së aseteve, shoqëria ka pasur të emëruar likuiduesen, e cila ka pasur të gjitha tagrat të kryejë veprimet juridike për llogari e në emër të shoqërisë, duke nënkuptuar që personi i lidhur, pavarësisht se ka qenë ortakë e vetme dhe administratore e shoqërisë, nuk kishte titull ligjor të kryente veprime mbi asetet e shoqërisë apo të dispononte në emër e për llogari të saj. Në këto kushte, Kolegji konstaton se kontrata për shitjen e aseteve në vlerën prej 600.000 lekësh, duket se është bërë në devijim të një rregullimi ligjor për sa i përket personit të autorizuar për kryerjen e një veprimi të tillë. Duket se në këtë rast, personi i lidhur ka vepruar në tejkalim të tagrave të saj në raport me shoqërinë, për shkak të fazës në të cilën shoqëria gjendej në kohën e kryerjes së këtij veprimi.

**16.13** Krahas këtij konstatimi, Kolegji vlerësoi çështjen në kuptim edhe të dispozitave që rregullojnë pasojat e veprimeve juridike që kryhen në tejkalim të tagrave ligjore dhe llojit të pavlefshmërisë që përcakton shkelja e dispozitave të kësaj natyre. Kjo analizë e dispozitave ligjore si vijon, synon të zbërthejë në vlerësimin e trupës gjyquese, qëllimin e parashikimeve ligjore të cituara më lart e që përcaktojnë detyrat e kompetencat e likuidatorit në fazën kur shoqëria gjendet në stadin “në likuidim e sipër”. Nga leximi harmonik i dispozitave, ndër të tjera, kuptohet se detyrat e funksionet e likuidatorit synojnë të mbrojnë e të garantojnë të drejtat e kreditorëve nga

---

<sup>34</sup> Rezulton se shoqëria “{\*\*\*}” ShPK është themeluar me anë të ligjit nr. 7638, datë 11.10.1998, “Për shoqëritë tregtare” dhe e ka mbyllur aktivitetin e saj bazuar në ligjin e ri nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për shoqëritë tregtare”, pasi ky i fundit në nenin 230 të tij ka parashikuar se shoqëritë e krijuara para hyrjes në fuqi të tij janë të detyruara të përshtatin organizimin dhe funksionimin e tyre, sipas dispozitave të këtij ligji, brenda 3 vjetëve pas hyrjes së tij në fuqi.

“Neni 230

Vijimi i funksionimit dhe detyrimi për përshtatje

[...] 2. Shoqëritë tregtare, që kanë ekzistuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë të detyruara të përshtatin organizimin dhe funksionimin e tyre, sipas dispozitave të këtij ligji, brenda 3 vjetëve pas hyrjes së tij në fuqi [...]”.

<sup>35</sup> Të marra nga Ekstrakti Historik i Regjistrit Tregtar, në open data: [www.qkb.gov.al](http://www.qkb.gov.al).

<sup>36</sup> Znj. D. Z.

arbitrariteti i sjelljes së ortakeve apo administratorëve të shoqërisë, përgjatë fazës tranzitore të prishjes së saj.

**16.14** Kolegji vlerëson se çështjet e arsytuarat më lart dhe anashkalimi i rregullave të përcaktuara në nenet 197 e 202 të ligjit nr. 9901/2008, do të shkaktonin potencialisht pavlefshmërinë relative të veprimit juridik, kontratë shitblerjeje e përshtuar më sipër. Shkelja e ligjit në këtë rast nuk do të sillte *ispo jure* pavlefshmërinë absolute të veprimit juridik, e për pasojë nulitetin e çdo pasojë ligjore që ka ardhur prej tij. Sipas parashikimit të nenit 94/1 të Kodit Civil, që përcakton se – *Të anulueshme quhen veprimet juridike, të cilat janë të vlefshme gjersa gjykata me kërkesën e të interesuarit i shpall të pavlefshme. Të tilla janë veprimet juridike të kryera nga: [...] – ky veprim juridik do të konsiderohet i vlefshëm përderisa gjykata e vënë në lëvizje me kërkesën e palës së interesuar apo të dëmtuar prej këtij veprimi, ta shpallë atë të pavlefshëm. Përtej këtij rregullimi të përgjithshëm rreth pasojave dhe efektshmërisë së një veprimi juridik relativisht të pavlefshëm, Kolegji konsideroi parashikimin e nenit 607 të Kodit Civil, i cili në mënyrë të posaçme rregullon situatën objekt verifikimi në lëmin e qarkullimit civil, sipas të cilit: *Kreditori ka të drejtë të kërkojë që të deklarohen të pavlefshme veprimet juridike të kryera nga debitori, me qëllim që të pakësojë sasinë ose vleftën e pasurisë së tij në dëm të kreditorit, me kusht që kredia të ketë lindur më parë se të jetë kryer veprimi juridik.* Kolegji vlerëson se kontrata e sipërcituar do të goditej në drejtim të ligjshmërisë së saj, nga çdo kreditor i cili do të pretendonte shkeljen e të drejtave të tij prej kryerjes së një veprimi juridik të tillë, në kundërshtim me parashikimet ligjore e që kishte cenuar interesat e tij. Për sa kohë që nuk ka informacione se një pretendim i tillë është ngritur, pasojat ligjore të këtij veprimi juridik do të duhet të konsiderohen të ligjshme në kuptim edhe të këtij procesi.*

**16.15** Në arsyetimin e mësipërm, Kolegji mbajti në konsideratë edhe të dhënat që tregojnë për mungesë të kreditorëve të pashlyer të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, interesat e të cilëve do të ishin cenuar prej këtij veprimi, të renditura si më poshtë:

- i. Nga aktet e sjella nga administrata tatimore e rajonale Fier, si dhe Drejtorja e Taksave e Tatimeve pranë Bashkisë Fier, nuk ka të dhëna për kreditorë të regjistruar të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK.
- ii. Nga aktet e gjendura ne platformën e QKB-së ([www.qkb.gov.al](http://www.qkb.gov.al)) dhe në regjistrin historik të kësaj kompanie, nuk ka të dhëna për ekzistencë të ndonjë kreditori të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK.
- iii. E njëjta situatë konfirmohet edhe nga akti i likuidimit të kësaj shoqërie, mbi të cilin është bërë çregjistrimi i saj nga QKB-ja, më 04.04.2019.
- iv. Nga të dhënat e evidentuara në aktin e likuidimit<sup>37</sup> të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, rezultojnë se vetëm vlera e kapitalit fillestar prej 100.000 lekësh, të investuar nga ortakja e vetme M. Ç., paraqitet si humbje gjatë gjithë jetës/aktivitetit të kësaj shoqërie.

**16.16** Në vlerësim të të gjithë situatës faktike, rezultojnë se edhe në versionin se këto asete si aktive të shoqërisë do të shiteshin nga likuidatori, në kushtet kur nuk ka të dhëna për ekzistencën e kreditorëve të shoqërisë, kopshtit “{\*\*\*}” ShPK, sërish këto të ardhura do të përfitoheshin në pikë fundore nga bashkëshortja e subjektit, në cilësinë e ortakës së vetme të kësaj shoqërie.

**16.17** Në këtë këndvështrim, Kolegji, pasi vlerësoi ligjshmërinë e krijimit të shumës prej 600.000 lekësh, në përgjigje të pretendimit të Komisionerit Publik, duke konsideruar shumën e përftuar prej 800.000 lekësh si jashtë regjimit të trajtimit, si e ardhur nga aktiviteti privat i bashkëshortes, konkludoi në analizë të dispozitave ligjore të zbatueshme që rregullojnë tagrat e likuidatorit dhe

<sup>37</sup> Akti i likuidimit i miratuar nga likuiduesja, i cili është lehtësisht i aksesueshëm nëpërmjet faqes zyrtare në internet: [www.qkb.gov.al](http://www.qkb.gov.al).

administratorit të shoqërisë në fazën e likuidimit, dhe konkretisht neneve 197-205 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, nenit 94, paragrafi 1 dhe nenit 607 të Kodit Civil, se nuk mund të ngrihen çështje të paligjshmërisë së këtij veprimi juridik, në raport me vlerën prej 600.000 lekësh, në kuadër të parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës për efekt të këtij procesi.

**16.18** Kolegji vlerësoi ligjshmërinë e së ardhurës që është përfituar prej kontratës së analizuar më lart, edhe në drejtim të plotësimit të kërkesave të nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016. Në këtë kontekst, referuar të dhënave që kanë rezultuar nga hetimi, konstatohet se vlera e shpenzuar për blerjen e këtyre pajisjeve në vite, është deklaruar 1.400.000 lekë. Në të njëjtën vlerë, rezulton se këto pajisje janë shitur me kontratën noteriale të shitblerjes nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., të datës 17.10.2010, e të deklaruar me të njëjtat të dhëna nga subjekti i rivlerësimit në DV-Periodike të vitit 2010. Në këto kushte, nuk konstatohet se midis vlerës së shpenzuar për blerjen e tyre dhe vlerës së përfituar prej shijes së tyre të rezultojë ndonjë diferencë e cila do të konsiderohej si fitim e do të duhej t’u nënshtruhej rregullave të ligjit nr. 8438/1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Kolegji vlerëson se, pavarësisht faktit se subjekti ka kryer vullnetarisht pagesën e kalkuluar sipas tij se i përket detyrimit tatimor për këtë transaksion, pas gjetjeve të bëra prezente nga Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit, kjo rrethanë mbetet irelevante dhe nuk afekton analizën dhe qëndrimin e trupit gjykues lidhur me këtë çështje.

**16.19** Në konkluzion edhe të kësaj çështjeje, duke vlerësuar ligjshmërinë e të ardhurave edhe në drejtim të shlyerjes së detyrimeve tatimore në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016, për sa kohë që nuk rezultuan të provuara diferenca mes çmimit të blerjes dhe shitjes së këtyre pajisjeve dhe nuk evidentohet ligjërisht nevoja e pagimit të ndonjë tatimi, Kolegji çmon se të ardhurat e pretenduara duhen konsideruar si të ligjshme edhe në këtë drejtim, në raport me nenin D të Aneksit të Kushtetutës.

17. *Në drejtim të vlerësimit të kriterit të pasurisë, Kolegji mori në shqyrtim edhe pretendimin e Komisionerit Publik, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e pamjaftueshmërisë financiare për të mbuluar me burime të ligjshme shpenzimet dhe kursimet e deklaruara në vitet 2005 dhe 2011, respektivisht në vlerën negative (-) 214.246 lekë në vitin 2005, dhe në vlerën negative (-) 447.060 lekë në vitin 2011.*

**17.1** Për analizimin sa më të plotë të këtij shkaku ankimi, duke u bazuar në aktet e administruara në fashikull, si dhe në ato të siguruara nga shqyrtimi gjyqësor, Kolegji kreu analizën financiare për njësinë familjare të subjektit të rivlerësimit për vitet 2005 dhe 2011. Në këtë analizë financiare<sup>38</sup>,

---

<sup>38</sup> Në analizën financiare të Kolegjit për vitet 2005 dhe 2011 janë përfshirë:

- Vlerat e “Të ardhurave nga pagat” për subjektin dhe bashkëshorten, janë marrë nga vërtetimet e pagave, përcjellë nga institucionet përkatëse, verifikuar me dokumentacionin bankar të administruar gjatë hetimit administrativ nga Komisioni.
- Gjendja e cash-it është përcaktuar mbështetur në deklaratat periodike të subjektit, si dhe në arsyetimin logjik të veprimeve financiare me likuiditetet dhe cash-in e periudhës dhe jo në përgjigjet e pyetësorit të dhënë Komisionit gjatë hetimit administrativ.
- Diferenca e likuiditeteve në Bankë është evidentuar sipas dokumentacionit bankar të disponuar në dosje, të llogarive bankare, ku subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja kanë pasur numra llogarie të hapura. Me diferencë likuiditetesh, kuptojmë diferencën e gjendjes në fillim të vitit me gjendjen në fund të vitit në llogaritë bankare të subjektit
- Shpenzimet për konsum familjar (prej 3 personash) janë për llogaritur me të njëjtën metodologji të përdorur nga ILDPKI-ja.
- Shumat e detyrimeve ndaj huadhënësve dhe shlyerja e tyre është mbështetur në deklaratimet e subjektit në deklaratimet periodike ndër vite.
- Shumat e interesave të përfituara janë evidentuar nga statement-et e llogarive bankare, të cilat disponohen në fashikull.

janë përfshirë “të ardhurat” nga të gjitha burimet e ligjshme, si dhe shpenzimet e kryera gjatë këtyre dy viteve objekt analize.

**17.2** Nga analiza e kryer në Kolegj për vitin 2005, rezulton se konfirmohet situata financiare negative (-) 214.246 lekë për subjektin e rivlerësimit, vlerë e cila ishte përcaktuar prej Komisionit dhe pretenduar edhe nga Komisioneri Publik në ankim.

**17.3** Lidhur me analizën ekonomike të kryer nga Kolegji për vitin 2011, ndryshe nga sa pretendon Komisioneri Publik për një diferencë negative prej (-) 447.060 lekësh, subjekti i rivlerësimit rezulton me situatë financiare pozitive në vlerën (+) 165.860 lekë. Kjo diferencë konstatohet se shkaktohet për shkak se Komisioneri Publik e ka ngarkuar me shpenzime për mobilimin e banesës në këtë vit financiar të gjithë shumën e deklaruar nga subjekti, në vlerën 863.660 lekë.

**17.4** Lidhur me këto shpenzime, Kolegji, pasi analizoi të gjithë informacionin e rezultuar prej hetimit administrativ në Komision, konstatoi se subjekti për këtë zë të shpenzimeve familjare, ka deklaruar përkatësisht se:

- Në pyetësorin fillestar ka deklaruar se shpenzimet e mobilimit janë në vlerën 6.000 euro deri në 7.000 euro, pa specifikuar se në cilin vit janë kryer ato.
- Në përgjigjet për pyetjet shtesë gjatë hetimit administrativ, subjekti ka detajuar se mobilimi i banesës në Tiranë është bërë në vazhdimësi në vitet 2011-2013, respektivisht në vitin 2011 për mobilim janë shpenzuar 1.800 euro, në vitin 2012 janë shpenzuar 3.000 euro dhe në vitin 2013 shuma prej 1.400 eurosh.

**17.5** Bazuar në këto shpjegime për mënyrën dhe shpërndarjen në vite të shpenzimeve të mobilimit, të dhëna nga subjekti përgjatë hetimit administrativ, që japin të dhëna rreth këtij shpenzimi, ashtu si edhe në raste të tjera të trajtuara nga jurisprudenca e Kolegjit, në analizën financiare të vitit 2011, ashtu sikurse edhe nga Komisioni, janë përfshirë vetëm shpenzimet për mobilim, në vlerën prej 1.800 eurosh, ekuivalente me 250.740 lekë, ndërsa janë shpërndarë në vitet 2012 e 2013 shpenzimet për pjesën e mbetur, sipas deklarimeve të subjektit. Duke përfshirë këto shpenzime për mobilim në këtë vit, situata financiare e subjektit për vitin 2011, paraqitet pozitive me vlerën (+) 165 860 lekë.

**17.6** Në përfundim të sa më sipër, situata financiare e subjektit për të gjithë periudhën 2003-2016, rezulton me mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar shpenzimet e kryera dhe pasuritë e krijuara vetëm në vitin 2005, në një vlerë të konfirmuar sa ajo e Komisionit, prej (-) 214.246 lekësh.

**17.7** Për pasojë, pasi analizoi këtë pretendim të Komisionerit Publik, mbështetur në analizën financiare të kryer në Kolegj, trupi gjykues arriti në konkluzionin se ai është i drejtë vetëm për sa i përket mungesës së burimeve të ligjshme që i korrespondon analizës financiare të vitit 2005, në vlerën prej (-) 214.246 lekësh, ndërkohë që rezulton se subjekti ka mundësi të përballojë me të ardhura të ligjshme pasuritë e shpenzimet e vitit 2011, vlerë e cila u konsiderua irelevante dhe e

- 
- *Shpenzimet e udhëtimit janë përllogaritur sipas të dhënave të sistemit TIMS për subjektin dhe personat e lidhur sipas metodologjisë së Kolegjit.*
  - *Shpenzimet në vitin 2005 janë marrë sipas deklarimeve të subjektit përgjatë hetimit administrativ, për blerje të një pjese të mobilieve të shoqërisë private.*
  - *Nuk janë marrë në konsideratë të ardhurat nga bonusi i karburantit, si dhe nuk është ngarkuar subjekti me shpenzime transporti, pasi ato kanë qenë të mbuluara nga bonusi i karburantit të përfituar.*
  - *Shpenzimet e shkollimit të së bijës janë llogaritur bazuar në deklaratimet e subjektit, si dhe duke u verifikuar me pagesat e kryera për kurset e shkollimit, sipas lëvizjeve të llogarive bankare.*
  - *Shpenzimet e mobilimit janë llogaritur sipas deklarimeve të subjektit në pyetësorët gjatë hetimit administrativ.*

pamjaftueshme, në zbatim të parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit që shoqërojnë analizimin dhe shqyrtimin e çështjeve sipas përcaktimit të nenit 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, për ta ngritur këtë situatë faktike në nivelin e shkeljes së ligjit që përcakton prezumimin e vendosjes së masës disiplinore.

**17.8** Në vijim të të gjitha konkluzioneve të arritura përgjatë këtij arsyetimi, pasi kreu vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, Kolegji arriti në konkluzionin se qëndrimi i Komisionit se subjekti ka arritur nivel të besueshëm në drejtim të kontrollit të këtij kriteri, në kuptim të nenit 59, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, është i drejtë.

## **ii. Lidhur me kriterin e kontrollit të figurës**

**18.** Në ankim, Komisioneri Publik lidhur me kontrollin e kriterit të figurës, ka pretenduar se: *Referuar nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës, kreu V të ligjit nr. 84/2016, rezulton se, në referencë të nevojës së kryerjes së një hetimi të plotë dhe verifikimit të ekzistencës eventuale të të gjitha kushteve të parashikuara nga neni 59 i ligjit nr. 84/2016, mangësitë në hetimin e Komisionit edhe në drejtim të administrimit të plotë të informacioneve nga të gjitha organet ndihmëse për kriterin e figurës, do të duhet të riparohen gjatë gjyqimit të këtij ankimi në Kolegj.*

**18.1** Komisioneri Publik, në parashtrimet para Kolegjit lidhur me kontrollin e kriterit të figurës, parashtrori se procedura e kontrollit të figurës së subjektit të rivlerësimit rezulton e paplotë, pasi raporti për kontrollin e saj, që mban datën 02.11.2017, i hartuar nga Grupi i Punës, në referencë të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, është përpiluar në mungesë të informacionit të një prej 3 institucioneve verifikuese. Në këto kushte, në respektim të parashikimeve ligjore të ligjit nr. 84/2016, është i nevojshëm përditësimi i raportit të datës 02.11.2017, me qëllim administrimin e informacionit nga institucioni verifikues, të dhënat e të cilit nuk janë marrë në shqyrtim nga DSIK-ja gjatë hartimit të raportit të parë.

**18.2** Subjekti i rivlerësimit e kundërshtoi si të panevojshëm këtë qëndrim të Komisionerit Publik, duke prapësuar se ky pretendim është tërësisht i pabazuar edhe në konsideratë të faktit se më datë 17.07.2020, DSIK-ja e ka pajisur atë me një Certifikatë të re të Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (kategoria “Tepër Sekret”), të vlefshme deri më datë 16.07.2025, duke prezumuar në këtë mënyrë se informacioni i institucionit verifikues që mungonte në raportin e parë, ka qenë pozitiv për subjektin. Për këtë qëllim, subjekti i rivlerësimit paraqiti në cilësinë e provës, kopje të kësaj certifikate dhe praktikës<sup>39</sup> së njoftimit të saj subjektit.

**18.3** Kolegji, në funksion të shqyrtimit të pretendimit të Komisionerit Publik lidhur me kontrollin e figurës, vendosi të kërkojë nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, shpjegime nëse ka administruar informacion nga Shërbimi Informativ Shtetëror për subjektin e rivlerësimit Petrit Çano para përgatitjes së raportit mbi kontrollin e figurës për këtë subjekt, me nr. {\*\*\*}, datë 02.11.2017, dhe nëse jo, a është informuar më pas nga ky institucion në lidhje me këtë subjekt. Kolegji kërkoi gjithashtu nga DSIK-ja të përditësonte raportin për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, në përputhje me detyrimet që ky institucion ka, në zbatim të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016.

**18.4** Në përgjigje të këtij kërkimi, DSIK-ja ka dërguar dhe është administruar si provë në këtë gjykim, raporti mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Petrit T. Çano<sup>40</sup>. Bazuar në

<sup>39</sup> Shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 24.07.2020, të drejtores së Menaxhimit dhe Dokumentacionit në Prokurorinë e Përgjithshme, me anë të së cilës i përcillet Certifikata e Sigurimit të Personit për Petrit Çano, e miratuar nga DSIK-ja më datë 17.07.2020, me afat 5-vjeçar, për njohjen me informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”.

<sup>40</sup> Përcjellë në Kolegjime shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 28.6.2021.

këtë raport [deklasifikuar pjesërisht me vendimin e KDZH-së nr. {\*\*\*}, datë 28.6.2021], rezulton se, nisur nga të dhënat e siguruar nga autoritetet verifikuese, është ndryshuar konstatimi fillestar i dhënë për subjektin e rivlerësimit Petrit Çano, nga përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës, në papërshtatshmëri për vazhdimin e detyrës, nisur nga informacionet mbi të cilat ngrihen dyshime për përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme, kryesisht në atë të shpërdorimit të detyrës.

**18.5** Pasi u njoh me këtë konkluzion, Komisioneri Publik parashitroi para gjykatës nevojën për verifikimin në burim të përmbajtjes së këtyre informacioneve, trajtimin procedural të tyre dhe krahasimin eventualisht me praktika të caktuara, për sa kohë që raporti pjesërisht i deklasifikuar nuk jepte të dhëna që mund të analizoheshin dhe të mundësonin mbajtjen e një qëndrimi rreth këtij kriteri.

**18.6** Në vijim të këtij kërkimi të Komisionerit Publik, por edhe në funksion të një hetimi të plotë e verifikimit të raportit të hartuar nga DSIK-ja, si një organ ndihmës i organeve të rivlerësimit kalimtar në kuptim të ligjit dhe interpretimit pajtues të Gjykatës Kushtetuese, mbajtur në vendimin nr. 2/2017, Kolegji, në zbatim të nenit Ç, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 21 dhe 22 të ligjit nr. 8457, të datës 11.02.1999, “Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror”, si dhe neneve 39, pika 2; 47 dhe nenit 49, pika 1, germa “c” e ligjit 84/2016, vendosi:

- Të verifikojë në institucionin informues, Drejtoria e Informacionit të Klasifikuar, dokumentacionin që përmban të dhënat e përcjella për subjektin e rivlerësimit, mbi të cilat është hartuar raporti mbi kontrollin e figurës, i datës 30 qershor 2021.
- Të kërkojë informacion nga strukturat përkatëse për statusin aktual të trajtimit të informacionit që lidhet me subjektin e rivlerësimit, të përcjellë te këto struktura prej institucionit informues. Kolegji aksesoi drejtpërdrejt informacionin e përcjellë në DSIK nga institucioni verifikues, veprim procedural i cili u krye edhe në prezencë të vëzhguesit ndërkombëtar të çështjes.

**18.7** Të dhënat e përftuara nga aksesimi i drejtpërdrejtë me informacionin, u trajtuan e u vlerësuan prej Kolegjit në përputhje me parashikimet ligjore të ligjit nr. 8457, të datës 11.02.1999, “Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror”, si edhe në zbatim të detyrimeve që vijnë nga parashikimet e nenit 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, i cili referon te neni 47 i ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, të cilat kufizojnë të drejtat e palëve, në këtë rast subjektit të rivlerësimit, për t’u njohur me informacione të klasifikuara si sekret. Në të njëjtën mënyrë, Kolegji administroi edhe informacionin e marrë prej strukturës përgjegjëse që kishte trajtuar informacionin e institucionit informues, e cila gjithashtu nuk iu vu në dijeni subjektit të rivlerësimit, për shkak se edhe ky informacion ishte i klasifikuar “sekret”.

**18.8** Në lidhje me këto verifikime, Komisioneri Publik iu mundësua vënia në dijeni me shkresat përcjellëse të dërguara në DSIK nga institucioni informues, si edhe përgjigjja e përcjellë në Kolegji nga struktura verifikuese e këtij informacioni, ndërsa ai nuk pati akses mbi informacionin e disponuar prej institucionit informues, pavarësisht mundësisë së dhënë për këtë qëllim prej gjykatës, për shkak të protokolleve të zbatuara nga ky institucion në lidhje me administrimin e informacionit të klasifikuar.

**18.9** Me këtë bazë të dhënash dhe këtë nivel aksesimi mbi informacionin e klasifikuar, Kolegji, mbështetur në të drejtën e Gjykatës për të vlerësuar të dhënat e klasifikuara pa cenuar të drejtat themelore të individëve dhe ato që prekin thelbin e një procesi të rregullt ligjor, në konsideratë edhe të udhëzimeve e qëndrimeve që vijnë nga jurisprudenca e GjEDNj-së, në çështjen *Regner vs Czech Republic*<sup>41</sup>, analizoi dhe vlerësoi këto të dhëna mbi bazën e parimit të ligjshmërisë e objektivitetit.

---

<sup>41</sup> Në këtë çështje, *Dhoma e Madhe e GjEDNj-së përsërit se parimi i kontradiktoritetit dhe parimi i barazisë së armëve janë thelbësorë për të pasur një proces të rregullt, por të drejtat që burojnë prej këtyre parimeve, duke përfshirë edhe*



**18.10** Në analizë të këtyre të dhënave, të nënshtruara vlerësimit të trupës gjyquese nën regjimin e informacionit të klasifikuar si sekret shtetëror, rezultoi se ato nuk sillnin informacion për kontakte të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar sipas përcaktimeve të nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës e neneve 34 e 39 të ligjit nr. 84/2016, por ngrinin dyshime për përfshirje të subjektit në një episod paligjshmërie në drejtim të ushtrimit të detyrës.

**18.11** Në këtë kuptim, konkluzioni i DSIK-së se subjekti duhet të konsiderohet i papërshtatshëm për të vazhduar ushtrimin e funksionit të tij, mbështetur në tagrat ligjore të këtij institucioni, u konsiderua prej Kolegjit si i pambështetur në fakte. Informacioni i verifikuar prej Kolegjit dhe i administruar edhe nga DSIK-ja nuk përmbante të dhëna që flisnin për kontakte të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit, për pasojë, konkluzioni i nxjerrë mbi dispozitat e ligjit që synojnë kontrollin e figurës pikërisht në drejtim të pasjes ose jo të kontakteve të papërshtatshme, u konsiderua i pambështetur në ligj.

**18.12** Gjithashtu, rezultoi se informacioni i përcjellë prej institucionit informues, hidhte dyshime mbi një veprimtari në kundërshtim me detyrën e subjektit, e cila do të finalizohet në të ardhmen e që varej e kushtëzohej nga disa ngjarje që nuk kishin ndodhur në kohën e marrjes së informacionit. Kolegji e analizoi këtë rrethanë në këndvështrim të disa fakteve të njohura prej Kolegjit, në kuptim të nenit 49, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, të cilat objektivisht pamundësonin ndodhjen e ngjarjes me të cilën kushtëzohej veprimtaria e dyshuar e subjektit. Në këto kushte, Kolegji u gjend para një situatë faktike në të cilën veprimi në kundërshtim me ligjin, i dyshuar se do të kryhej prej subjektit, logjikisht dhe objektivisht nuk kishte ndodhur. Për pasojë, Kolegji mbeti pa lëndën që do të përbënte objektin e verifikimit e vlerësimit të sjelljes së subjektit, ndonëse jo në kuptim të kontrollit të figurës sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016, por në drejtim të elementeve që lidheshin me indikatorin e integritetit, si një prej treguesve të matshëm në kuadër të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit.

**18.13** Përveç sa më lart, Kolegji konsideroi në drejtim të vlerësimit të informacionit që buronte nga institucioni informues edhe qëndrimin e mbajtur prej strukturës përkatëse verifikuese, në raport me këtë informacion. Sipas komunikimit me këtë strukturë, nëpërmjet transmetimit të të dhënave të cilat u trajtuan gjithashtu si të klasifikuara – për shkak se informacioni që gjeneronte këto komunikime ishte trajtuar si i klasifikuar “sekret” – Kolegji mori dijeni se informacioni i përcjellë nga institucioni informues e që lidhej me veprimtari në kundërshtim me detyrën të subjektit të rivlerësimit, nuk kishte pasur si konsekuencë ndonjë veprimtari verifikuese apo kontrolluese të mëtejshme prej strukturës kompetente. Në këto kushte, edhe rrethana e përmendur në raportin e hartuar prej DSIK-së, i cili konstatonte papërshtatshmërinë e subjektit, mbështetur veçanërisht mbi faktin se informacioni i ishte përcjellë strukturës verifikuese, mbetet jorelevante në mbështetje të konkluzionit të mësipërm.

**18.14** Të gjitha rrethanat e mësipërme, edhe në dritën e faktit se subjekti i rivlerësimit deri ditën e përcjelljes së informacionit prej institucionit informues, në muajin shtator 2020, që lidhej me një episod të vetëm, nuk kishte pasur në ngarkim të tij të dhëna që ta përfshinin atë në veprimtari të kundërligjshme apo në kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar, u konsideruan prej Kolegjit pa vlerë për të ndryshuar vlerësimin e bërë prej Komisionit për kontrollin e figurës për subjektin.

---

*të drejtën për t'u njohur me provat, nuk kanë një natyrë absolute, për sa kohë që mund të ketë interesa konkurruese, siç është siguria kombëtare, që duhen marrë në konsideratë dhe të kenë përparësi karshi të drejtave procedurale të palëve.*

**18.15** Duke marrë në konsideratë këto të dhëna, Kolegji arriti në përfundimin se raporti i grupit të punës pranë DSIK-së, i cili deklaronte të papërshtatshëm subjektin e rivlerësimit, mbështetej jo vetëm mbi të dhëna të pakonfirmuara nga organet verifikuese që kanë trajtuar informacionin, por edhe të dhëna që dilnin jashtë kontekstit të objektit që lidhet me kriterin e kontrollit të figurës, sipas përcaktimeve të dispozitave kushtetuese dhe ligjore.

Në këto kushte, ky konkluzion i vlerësuar edhe në raport me të dhënat e administruara përgjatë gjithë procesit për subjektin e rivlerësimit, e çoi Kolegjin në përfundimin se qëndrimi i Komisionit se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm në drejtim të kontrollit të figurës, në kuptim të nenit 59, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, është i drejtë.

### **iii. Lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale**

**19.** Në ankimin e Komisionerit Publik objekt shqyrtimi, konstatohet se deklarohet se ky ankim paraqet për të tria kriteret e rivlerësimit, por pa identifikuar shkaqe të dedikuara vlerësimit të aftësive profesionale. Me paraqitjen e parashtrimeve në gjykim, Komisioneri Publik pretendoi dhe kërkoi nga Kolegji se duhej të zhvilloheshin hetime nga trupa gjykuese edhe në drejtim të vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale. Komisioneri e mbështeti pretendimin e tij në ngjarje e fakte të ndodhura pas dhënies së vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi e që lidheshin me një sërë problematikash të konstatuara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë e zyrën e prokurorisë pranë saj, për të cilat nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë (në vijim “ILD”) ishte iniciuar procedimi disiplinor ndaj një magjistrati prokuror, B. M., i cili ishte konkluduar me shkarkimin e këtij të fundit nga detyra, sipas vendimit nr. 81, datë 31.03.2021, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë (në vijim “KLP”). Nga përmbajtja e këtij vendimi, të konsultuar në faqen zyrtare të KLP-së, Komisioneri Publik parashtrroi se rezulton se një nga shkeljet disiplinore të kryera nga ana e magjistratit në fjalë, që ka shërbyer për shkarkimin e tij nga detyra, është mosushtrimi i ankimit në Gjykatën e Apelit, në të katra çështjet gjyqësore, të cilat janë referuar për procedim disiplinor nga ana e ILD-së.

**19.1** Komisioneri Publik detajoi më tej kërkimin e tij duke evidentuar se, përveç rasteve të referuara nga ana e ILD-së, referuar përmbajtjes së vendimit nr. 81, datë 31.3.2021, për periudhën 1.1.2017 - 1.7.2020, magjistrati/prokurori konkret, që ushtronte funksionet në prokurorinë e drejtuar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar në shkelje të ligjit, për shkak të mosushtrimit të ankimit në shkelje të ligjit, për 4 vendime të dhëna mbi kërkesat e të dënuarve me objekt: “Llogaritje kohe paraburgim” dhe 7 vendime mbi kërkesat e të dënuarve me objekt: “Përfitim nga amnistia”.

**19.2** Komisioneri Publik pretendoi se, duke marrë shkas nga këto situata faktike e ligjore të parashtruara më lart, si pjesë e vlerësimit të kriterit të aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e drejtuesit të prokurorisë, kërkoi që Kolegji të kryente hetime të mëtejshme duke specifikuar gjithashtu edhe nevojat për hetim në rastin konkret.

**19.3** Subjekti i rivlerësimit e kundërshtoi këtë qëndrim duke e konsideruar si të pabazuar në ligj dhe në tejkallim të shkaqeve të ankimit. Subjekti prapësoi se ligjet e miratuara rishtas në kuadër të reformës në drejtësi dhe në kushtet kur është krijuar Inspektorati i Lartë i Drejtësisë, ia njohin këtij të fundit kompetencën për verifikimin e ankesave, hetimin me nismë të shkeljeve dhe fillimin e

procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, sipas procedurës së përcaktuar me ligj.

**19.4** Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit deklaroi se edhe referuar procedimit të magjistratit/prokuror B. M., sipas asaj që pasqyron vendimit nr. 81, datë 31.03.2021, i KLP-së, rezultoi se magjistrati nuk ka konsideruar kërkesat apo qëndrimet e subjektit të rivlerësimit nga pozicioni i tij drejtues dhe kjo ka qenë një ndër rastet e shkeljeve disiplinore të konstatuara për të. Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik për verifikimin e ushtrimit të kompetencës së subjektit për të udhëzuar ushtrimin e ankimit apo dhënë udhëzime jo të detyrueshme për prokurorët, subjekti solli në vëmendje të Kolegjit ndryshimet kushtetuese dhe ligjore që kanë ndodhur në mënyrën e organizimit të institucionit të prokurorisë, me miratimin e ligjit nr. 76/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, që miratoi ndryshimet kushtetuese, ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 37/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, drejt decentralizimit të këtij institucioni e modifikimit të rolit të drejtuesit në prokurori.

**19.5** Kolegji, pasi dëgjoi parashtrimet e pretendimet e palëve, mori në analizë problematikën ligjore të krijuar për shkak të rrethanave procedurale që lidhen me kufijtë e shqyrtimit të ankimit. Në këtë kontekst, Kolegji analizoi pretendimin e Komisionerit Publik të parashtruar në ankim, për një vlerësim të tri kritereve të rivlerësimit, si të pamjaftueshme për t’u konsideruar se kërkimi i tij në seancë për hetime të mëtejshme ishte një kërkim që do të konsiderohej si i paraqitur si një shkak ankimi. Fakti që Komisioneri në ankim, ka përmendur edhe vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, por pa specifikuar shkakun konkret mbi të cilin duhej të orientohej roli kontrollues i Kolegjit, vlerësohet nga trupa gjyqësore si një deklaram që nuk mbart detyrim për Kolegjin në drejtim të kontrollit të vendimit të Komisionit edhe për sa i përket këtij kriteri aq më tepër për ngjarje e fakte që nuk kanë ekzistuar në kohën e marrjes së vendimit të Komisionit. Kolegji çmon se garantimi i të drejtave të palëve për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 6 të KEDNJ-së, kërkon që ankimi i paraqitur nga Komisioneri të përmbajë në mënyrë të qartë shkaqet mbi të cilat ai mbështetet dhe për të cilat ai kërkon të ushtrohet juridiksioni kontrollues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit. Në këtë kuptim, subjektet e rivlerësimit kanë të drejtë të njihen me këto pretendime e atyre t’u garantohet e drejta për t’u dëgjuar e mbrojtur, si edhe zbatimi i një sërë parimeve të tjera të procesit të rregullt gjyqësor. Në këtë logjikë, Kolegji nuk ka *ipso jure* detyrimin t’i përgjigjet me hetim një pretendimi të shtruar në kushte të tilla në çdo rast.

**19.6** Pavarësisht këtij qëndrimi, Kolegji vlerësoi dhe analizoi pretendimin/kërkimin dhe informacionin e përcjellë prej Komisionerit Publik, me cilësinë e mbrojtësit të interesit të publikut, sipas tagrave kushtetuese dhe ligjore, si një e dhënë që duhej vlerësuar prej trupit gjyqësor në procesin e rivlerësimit të subjektit Petrit Çano. Situata e prezantuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë, në të cilën subjekti ushtronte funksione drejtuese prej disa vitesh, në lidhje me gjykimin e kërkesave në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale, u vlerësua prej trupës

se meritonte vëmendjen dhe kryerjen e disa verifikimeve në drejtimet e propozuara prej Komisionerit. Me propozim të gjyqtares relatores të çështjes, në zbatim të autorizimit ligjor që japin nenet 41, pika 4 dhe 43, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, u miratua nga trupa gjyqësore vendimi për të kryer hetimet e kërkuara në këtë drejtim, në konsideratë të informacionit të përcjellë në gjykim nga Komisioneri Publik, si një përfaqësues legjitim i publikut në këtë proces.

**19.7** Për sa më sipër, Kolegji vendosi të kërkojë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë dhe nga prokuroria pranë saj aktet e pretenduara e të specifikuara në seancë gjyqësore prej Komisionerit Publik<sup>42</sup>. Gjithashtu Kolegji administroi dhe vlerësoi në kuadër të kësaj çështjeje edhe provat e paraqitura në gjykim prej subjektit të rivlerësimit, që lidhen me ushtrimin prej tij të funksioneve të titullarit dhe që kanë të bëjnë me udhëzime drejtuar prokurorëve për ushtrim ankimi dhe veprime të mëtejshme hetimore, urdhra të ndryshëm në funksion të organizimit të zyrës, si edhe procesverbale të hedhjes së shortit për ndarjen e çështjeve prokurorëve, në përgjigje të pretendimit të Komisionerit Publik për vlerësimin e aftësive të tij profesionale.

**19.8** Nga të dhënat që rezultuan nga aktet e përcjella prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, u konstatua se i gjithë informacioni i përcjellë kishte natyrë statistikore, pa të dhëna që tregonin përmbajtjen e çështjeve apo specifika të rasteve konkrete. Për shkak të natyrës së këtij informacioni, Kolegji arsyetoi mbi mundësinë dhe relevancën e këtij informacioni drejt vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit.

**19.9** Kolegji e konsideroi objektivisht të pamundur të kryente një vlerësim mbi aftësitë profesionale të subjektit në ushtrimin e funksioneve të tij si drejtues i prokurorisë, referuar shifrave që pasqyroheshin në këto akte shkresore. Së pari, numri i çështjeve të gjykuara dhe ankimuarra në lidhje me kërkesat e të dënuarve në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale, mbeten statistika që tregojnë për volumin e punës në një prokurori, në drejtim të këtyre gjykimeve. Gjykimi mbi cilësinë e punës së subjektit si drejtues mbi këto shifra, do të ishte i padrejtë dhe i pambështetur as në një panoramë të plotë të situatës faktike dhe as në dispozitat ligjore që rregullojnë kompetencat e drejtuesit të zyrës pas ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore, që janë miratuar me miratimin e paketës së reformës në drejtësi. Mungesa e të dhënave rreth çështjeve e bën të pamundur vlerësimin e rolit të subjektit në rastet e paankimuarra nga prokurorët e çështjeve. Pavarësisht kësaj, edhe në

---

<sup>42</sup> **i)** Administrimin e informacionit nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë, Krujë, në lidhje me numrin e kërkesave të gjykuara (për të cilat është dhënë vendim mbi kërkimin e kërkuarit/të dënuarit) gjatë fazës së ekzekutimit të vendimeve penale dhe vendimeve përkatëse me objekt: (i.i) qëndrimi në shtëpi (neni 59/a i K. Penal); (i.ii) lirim para kohe me kusht (neni 64 dhe 65 i K. Penal); (i.iii) llogaritje e paraburgimit; (i.iv) njohje amnistie; të shqyrtuara me prezencë të prokurorit pranë kësaj gjykate, në periudhën 1.1.2016 - aktualisht.

**ii)** Administrimin e informacionit nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë, në lidhje me numrin e ankimeve të paraqitura nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Krujë, për vendimet e dhëna nga kjo gjykatë, për kërkesa të paraqitura gjatë fazës së ekzekutimit të vendimeve penale dhe vendimarrjen përkatëse të Gjykatës së Apelit.

**iii)** Administrimin e informacionit nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Krujë, në lidhje me ekzistencën eventuale të udhëzimeve të hartuara nga ana e drejtuesit të Prokurorisë, sipas shkronjës "c", të nenit 43, pikave 1, 2, 4 të nenit 46 dhe shkronjës "c", pika 1, pikat 2, 3, 4 dhe 6, neni 48, në lidhje me ushtrimin e funksioneve të Prokurorisë gjatë fazës së gjykimin të kërkesave të paraqitura nga ana e të dënuarve, në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale, duke administruar për efekt të këtij procesi, kopje të këtyre akteve.

**iv)** Administrimin e informacionit nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë, për shpërndarjen të prokurorët të çështjeve me objekt kërkesat e të dënuarve gjatë fazës së ekzekutimit të vendimeve penale me burgim.

një këndvështrim statistikor, Kolegji arsyeton se ai duhet të bëhet duke analizuar numrin e përgjithshëm të kërkesave e gjykimeve dhe jo vetëm raportin e ankimeve me vendimet që kanë pranuar kërkesat e dënuarve, siç ka pretenduar Komisioneri Publik në konkluzionet përfundimtare, pasi një analizë e tillë do të jepte një konkluzion të deformuar edhe në planin statistikor.

**19.10** Së dyti, në analizën e tij, Kolegji mban parasysh rolin dhe kompetencat e drejtuesit të zyrës pas ndryshimeve ligjore të cituara më lart. Ridimensionimi i këtij roli, sipas parashikimeve ligjore, ka përcaktuar kufijtë dhe natyrën e ndërhyrjes së drejtuesit në raport me vendimet e prokurorit të çështjes për të kryer hetime dhe për të marrë vendime që lidhen me procedimet penale. Përveç rolit si administrator i zyrës, në planin e procedimeve penale, kompetencat e drejtuesit të përkthyer në nenet 43/b<sup>43</sup> e 48/3<sup>44</sup> të ligjit nr. 97/2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” përfaqësojnë autoritetin mbikëqyrës në terma të përgjithshëm, në drejtim të zbatimit të politikave penale të institucionit e ndjekjes së direktivave të përcjella nëpërmjet udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm. Në vlerësimin e Kolegjit, kuadri ligjor në fuqi lë mundësinë të gjyqosh rolin dhe zbatimin korrekt të ligjit nga drejtuesit e zyrës, duke vlerësuar rast pas rasti rrethanat dhe peshën e çështjeve të caktuara, pasojat që ka prodhuar vepra penale konkrete apo impaktin e saj në publik, në raport me veprimtarinë individuale të drejtuesit. Në këtë plan, subjekti i rivlerësimit përcolli para Kolegjit disa akte të përpiluara prej tij, nëpërmjet të cilave ai kishte tentuar të tërhiqte vëmendjen jo vetëm të prokurorëve të zyrës, por edhe të institucioneve të tjera përgjegjëse rreth një veprimtarie që nuk ishte vlerësuar korrekte prej tij për çështje të konsideruara me impakt të gjerë publik<sup>45</sup>.

**19.11** Së treti, Kolegji konstatoi se fusha e veprimtarisë së subjektit si mbikëqyrës i prokurorisë ku ai ushtron funksionet, ka qenë dhe është lëndë në të cilën kanë juridiksion kontrollues e vlerësues ILD-ja e KLP-ja, që nga momenti i konstituimit të tyre si organe që kontrollojnë magjistratët në ushtrimin e funksioneve të tyre qoftë në drejtim të procedimeve disiplinore, qoftë në drejtim të vlerësimit periodik të aftësive të tyre profesionale, veprimtari e cila përmbyllet ligjërisht nga kontrolli kushtetues në juridiksionin disiplinor, që ushtron vetë Kolegji i Posaçëm i Apelit. Veçanërisht, kontrolli i rolit drejtues të magjistratit kur ai nuk është i adresuar apo dedikuar një rasti konkret e që përfaqëson një sjellje konkrete të tij, konsiderohet prej Kolegjit se bën pjesë tipikisht në juridiksionin e zakonshëm kontrollues e vlerësues të organeve të reja të drejtësisë, edhe në zbatim të neneve 79-82 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

---

<sup>43</sup> Drejtuesi i prokurorisë ka këto kompetenca në lidhje me ushtrimin e ndjekjes penale: a) [...]; b) kërkon informacion për ecurinë e procedimeve dhe, nëse është e nevojshme, nxjerr udhëzime me shkrim, sipas këtij ligji.

<sup>44</sup> Udhëzimet në lidhje me procedime konkrete, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, mund të jepen kryesisht në momentin e caktimit të çështjes për ndjekje prokurorit, ose më pas, kur vlerësohet e nevojshme për mbarëvajtjen e ecurisë së procedimit.

<sup>45</sup> Dërgohet informacion për lirimin me kusht të të dënuarit G. T., nr. {\*\*\*} prot. datë 13.11.2017.

- Dërgojmë urdhrin e ekzekutimit të vendimit penal nr. {\*\*\*}, datë 17.05.2021, të Gjykatës së Apelit Tiranë, për kërkesin G. T..

- Informacion në lidhje mbi gjykimin e kërkesës për lirimin me kusht të të dënuarit me burgim të përjetshëm E. D..

**19.12** Përfundimisht, pas vlerësimit të të gjitha argumenteve të renditura më lart, Kolegji arrin në konkluzionin se analiza e të dhënave të cilat referohen edhe prej Komisionerit si informacioni që duhet të vlerësohet për të përcaktuar se si subjekti ka ushtruar funksionet drejtuese, si pjesë përbërëse e funksioneve të prokurorit/magjistrat, në kuadër të procesit të rivlerësimit, është e pamundur të kryhet. Referimi tek analiza e të dhënave statistikore, të cilat pretendohen se demonstrojnë nivelin e aftësive të subjektit si magjistrat, për shkak të ushtrimit të funksioneve si drejtues, konsiderohet e papërshtatshme për të arritur në konkluzione objektive e të mbështetura në ligj, për sa kohë që çështjet në vetvete nuk ekspozohen në këtë informacion dhe që nuk rezulton ndonjë e dhënë konkrete e cila do të legjitimonte hetimin e mëtejshëm të rastit prej trupit gjykues. Kolegji mban në konsideratë në këtë analizë edhe faktin që veprimtaria e trajtuar se duhet t'i nënshtrohet këtij vlerësimi, ka qenë dhe është një realitet për institucionet e reja të sistemit të drejtësisë, të ngarkuara posaçërisht me kompetencën dhe detyrën për vlerësimin e magjistratëve prokurorë apo dhe me hetimin e shkeljeve disiplinore apo të çfarëdo natyre tjetër të kryera prej tyre.

**19.13** Për shkak të këtij arsytimi, duke mos evidentuar problematika konkrete në ushtrimin e funksioneve si prokuror dhe drejtues prej subjektit të rivlerësimit, pas analizës së të dhënave të administruara në proces, Kolegji arriti në konkluzionin se qëndrimi i Komisionit se subjekti ka arritur nivel minimal kualifikues në drejtim të aftësive të tij profesionale, në kuptim të nenit 59, pika 1, germa "c" e ligjit nr. 84/2016, është i drejtë.

- 20.** Mbështetur në konkluzionet e mësipërme, referuar të tria kritereve të rivlerësimit, Kolegji vlerësoi edhe pretendimin e Komisionerit Publik se, nga vlerësimi i përgjithshëm i këtyre kritereve, konkludohet se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë. Nga analiza e të gjitha fakteve që rezultuan nga hetimi administrativ dhe gjyqësor i çështjes, Kolegji nuk evidentoi rrethana që meritonin të konsideroheshin në një vlerësim të përgjithshëm të të tria kritereve. Mungesa e burimeve të ligjshme për të përballuar pasuritë e vëna e shpenzimet e kryera për vitin 2005, në vlerën -214.246 lekë, mbetet e vetmja rrethanë e provuar sipas një standardi të pranuar, se është një shkelje e ligjit e kryer nga subjekti. Çështjet e tjera të shqyrtuara nuk arritën të bindin Kolegjin se duhen konsideruar si shkelje, të cilat meritojnë trajtimin dhe analizën në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

**20.1** Në vijim të arsytimit dhe konkluzioneve të mësipërme në funksion të vlerësimit të përgjithshëm të tri kritereve të procesit të rivlerësimit, sipas pretendimit të Komisionerit Publik, Kolegji çmon se zbatimi i nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në rrethanat e përshkruara, nuk të çon në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

- 21.** Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, Kolegji çmon se kërkimi përfundimtar i Komisionerit Publik, se nga vlerësimi i përgjithshëm i të tria kritereve të procesit të rivlerësimit, rezulton që subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, është një konkluzion i pambështetur në situatën faktike dhe parashikimet ligjore.
- 22.** Në këto kushte, Kolegji çmon se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 183, datë 19.07.2019, i cili ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Petrit Çano, është

marrë në vlerësim të drejtë të fakteve e provave të administruara gjatë hetimit e në zbatim të drejtë të dispozitave ligjore që rregullojnë procesin e rivlerësimit. Si i tillë, ai konsiderohet edhe pas këtij gjykimi, për pasojë ai duhet të qëndrojë në fuqi.

### **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 183, datë 19.07.2019, që i përket subjektit të rivlerësimit Petrit Çano.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, më datë 21.09.2021.

#### **ANËTARE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

#### **ANËTAR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

#### **ANËTAR**

**Ardian HAJDARI**

*nënshkrimi*

#### **RELATORE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

#### **KRYESUESE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*